

BERNARD HENRY LEVY

Ne mbrojtje
te Angela
Merkelit



FRANCI FUKUYAMA

Ballafaqimi
me shtetin
Islamik



L'ESPRESSO

Te gjithë
ne rrjeten
e kiber-krimet

Politika

Botim elektronik i NEP ne bashkëpunim me Bota.al-Mars 2018

KOHA E HILARISE

GRA NE PUSHTET / A do ta thyeje "tavanin e xhamte" ish Zonja e Pare?





Programi i Shkollës së Studimeve Politike financohet nga Këshilli i Evropës dhe Zyra e Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri si edhe vetë kontributet e pjesëmarrësve



Botim elektronik i Akademisë së Studimeve Politike në bashkëpunim me Bota.al

bota.al

Friday, June 20, 2014

HOME BOTA EKONOMI TEKNOLOGJI HISTORI SHKENCE KULTURE DOSSIER SPORT

INTERVISTA/Habermas: Propozimi im për një Union më demokratik

Jürgen Habermas është sociolog dhe filozof gjerman, i traditës së teorisë kritike dhe pragmatizmit. Ai është bërë i njohur për teoritë e tij të racionalitetit të komunikimit dhe sferës publike. Sipas sondazheve globale, Habermasi pranohet gjerësisht si një prej...

June 19, 2014

BOTIMESHQIP.COM

Në Shqipëri ju i merrni librat brenda 24 orëve dhe i paguani lehtë në dorë kur merrni librat.

Në çdo vend tjetër të botës ju i merrni librat brenda pak ditësh dhe mund të paguani me PayPal, transferë bankare, etj.

botimeshqip.com
Libri Shqip në shqipëri tani!

Kontaktet:
Akademia e Studimeve Politike
Adresa:
Qendra Kotoni,
Rr.Donika Kastrioti,
Nr.3,
Kati 4, Zyra 2,
Tirane, Shqipëri
Tel: +355 4 227 2173,
Tel: +355 4 450 4788
E-mail: info@asp.al
Web: www.asp.al
dhe www.bota.al

Përzgjedhja, redaktimi dhe përkthimi i materialeve në këtë buletin kryhet nga alumni i Shkollës Shqiptare të Studimeve Politike, z. Ermal Gjinaj



PER POLITIKEN:

Për mua, është e domosdoshme të krijoj një imazh fituesi, kështu që, më duhet të mund dikë...

Richard Nixon

Një prej penalteteve për mospërfshirjen në politikë, është se përfundon të qeverisesh nga njerëz që janë inferiorë

Platoni

Vendet më të errët të Ferrit u janë rezervuar atyre që ruajnë neutralitetin në kohë krize

Dante Aligieri

Politika është lufta pa gjakderdhje, ndërsa lufta është politikë me gjakderdhje

Mao Cedun

Politikanët e këqinj dërgohen të qeverisin, prej njerëzve të mirë që nuk votojnë

William E. Simon



Në mbrojtje të Angela Merkelit

NGA BERNARD-HENRI LEVY

Avantazhi i kopertinës famëkeqe të “Der Spiegel”, që shfaqte kancelaren gjermane Angela Merkel përballë Akropolit në Athinë, të rrethuar nga oficerët nazistë, është se ajo më në fund paraqiti në një mënyrë që nuk mund të injorohet, çështjen e Gjermanofobisë në Evropë. Kjo dukuri ka kohë që gjallon në fakt.

Në fillim ishin demonstratat në Qipro në mars të vitit 2013, me protestuesit që mbanin pankarta me karikaturat e kancelares gjermane, si dikatori nazist Adolf Hitler. Thuajse në të njëjtën periudhë në Valencia të Spanjës, me rastin e Fallasit vjetor, Merkel u paraqit si një drejtoreshë e keqe shkolle, duke i dhënë kreut të qeverisë spanjolle dhe ministrave të tij “10 Urdhëresat e Angela Shfarosëses” dhe duke djegur portretin e saj në sheshin e Shën Jozefit. Dy muaj më vonë, në Portugali, pati manifestime të ngjashme, ku u shfaqën karikatura të përfaqësuara të së njëjtës Merkel të Hitlerizuar, ndërsa demonstruesit me të zeza ulërisnin dhe dënonin “politikën e masakrimit të të varfërve” nga ana e udhëheqësve gjermanë.

Natyrisht nuk mund të mungonte Greqia, ku fenomeni arriti apogjeun e tij gjatë trazirave të tetorit të vitit 2012, tek të cilat bota pa spektaklin e nazistëve dhe flamujve gjermanë që u valëvitën së bashku e pastaj u dogjën para Akropolit, në skenat që imitoi së fundmi edhe “Der Spiegel” me kopertinën e vet.

Në apel ishte edhe Italia, ku e përditshmja kombëtare e krahut të djathtë “Il Giornale”, nuk kishte skrupuj kur me kryeartikullin e saj të datës 3 gusht 2012 shprehej: Shfaqja e Rajhut të Katërt. Janë edhe vendet e Evropës veriore, ku faqet e internetit të konspiracionit pretendojnë të gjejnë tek padurimi i Gjermanisë për të mbështetur Poroshenkon kundër Putinit, një rimishërim të nënshtrimit të

Ukrainës ndaj Hitlerit. Për të mos përmendur Francën, ku nga e djathta ekstreme (zonja Le Pen e akuzoi kancelaren për “vuajtjet” që ajo ka imponuar mbi popujt e Europës), në të majtën ekstreme (Zoti Melenshon kundërshtoi ashpër politikën “shtrënguese”, duke e ftuar zonjën Merkel “ta mbyllë gojën”), duket se ka një garë se kush të mundë tjetrin me denoncime populiste të reja ndaj së resë dhe të neveritshmes “Perandori Gjermane”.

Problemi me këtë Gjermanofobi nuk është thjesht se ajo është diçka idiote. Nuk është as një tjetër simptomë e dekompozimit, nën sytë tanë, të projektit fisnik evropian. Jo, në kundërshtim me atë që fillestari në lëmin e magjisë që i fryn zjarrit e që do që ne ta besojmë, problemi është se kjo është një shenjë jo e kundërshtimit të atyre nxënësve, por më tepër të besnikërisë së tyre dhe madje edhe kontributi i tyre ndaj fashizmit të vërtetë qëndron në horizont. Përse? Për disa arsye.

Si fillim duhet thënë se të shprehesh se Merkeli është si Hitleri do të thotë ta banalizosh këtë të fundit. Për të vënë shenjën e barazimit, përtej çdo debati legjitim se edhe politikën sociale, ekonomike dhe diplomatike të Gjermanisë mund të frymëzojë një nga demokracitë më të ndershme dhe shembullore në kontinent, me regjimin që në Evropë mbetet simbol i shkatërrimit, jo vetëm i demokracisë, por i mbarë qytetërimit, është si ta pastrosh atë regjim, të garantosh dhe inkurajosh ata që janë nostalgjikë për të, dhe për t’i lejuar ata, me qëllim ose jo, të hidhen sërish në debatin publik. Për më tepër (dhe ky është thelbi), ata që janë të interesuar të diskreditojnë zonjën Merkel, ndodh të jenë të njëjtit njerëz që nuk hezitojnë të vallëzojnë ose formojnë aleanca me neo-nazistët vjenezë, në Athinë, me drejtuesit e një partie ndershmërisht ekstremiste. E gjithë tymnaja e ngritur rreth një Gjermanie, që gjoja është “ribashkuar me demonët e saj”, ka efektin e maskimit të zërit të tyre fashistoid, në mos partitë sinqerisht neo-naziste të cilat, që nga Agimi i Artë në Greqi, tek Jobbik në Hungari, nga SNS e Sllovakisë tek Vlaams Belang e Belgjikës dhe Ataka e Bullgarisë, janë në fakt në procesin e vendosjes në pozita drejtuese në Evropë.

Unë shtoj se zonja Merkel është një grua dhe se urrejtja për gratë, përbuzja ndaj tyre, është e ngjashme me sjelljen ndaj hebregjeve, që konsideroheshin nga teoricienët racistë të viteve ’20-’30, dhe që ka qenë një dimension thelbësor i çdo shprehjeje të fashizmit. Unë shtoj se sloganet e hedhura me hobenë në Valencia në tetor 2012, mënyra sesi demonstruesit u nxitën të brohorasin ndaj portreve të kancelares “Ju do të dashuroni paratë mbi të gjitha” dhe “Ju do të nderoni bankat dhe Bankën”, kishte aromën e një faulli të pagabueshëm e mantrave të vjetra rreth “demit të artë” dhe “plutokracisë kozmopolite”.

Njerëzit, më në fund po e kuptojnë se anti-amerikanizmi, i lindur në të djathtën ekstreme dhe ushqyer, në Gjermani, për shembull, nga ithtarët e Hajdegerit, është një ushqyes i përhershëm i fashizmit. Tani është koha që ne të kuptojmë se kjo është e vërtetë edhe për Gjermanofobinë që, në Francë, u shfaq me romancierin francez anti-semit dhe aktivistin Moris Bares, i cili pa tek Kantianizmi mjetin për “Çifutizimin” e mendjes evropiane.

Kjo linjë triumfoi me Charl Moranë me Aksonin Francez dhe luftën e tij të gjatë me “çifutët dhe abstraksionet gjermanike”. Kulmi u arrit me celulat kuqe-kafe që edhe sot, në faqe interneti që unë nuk preferoj t’i përmend, ofrojnë “ushqim” dhe një “strofull” për personat që dëshirojnë të “përplasen” me “bosët” në “listën e pagave të kancelares”. Historia e ideve e ka logjikën e vet, arsyen dhe budallallëkun e vet, të pavetëdijshmen dhe trajektoren e vet. Është sa e kotë aq edhe e rrezikshme, për të mohuar ndonjë prej tyre. Dhe kjo është arsyeja përse, sot mua më duket shumë e rëndësishme, përballë një force të errët që është në rritje, të mbroj Angela Merkelin. /“Huffingtonpost”/

Shënim: Bernard-Henri Levy është filozof dhe shkrimtar francez



Z. Kissinger, mund të ketë një zgjidhje për krizën e Ukrainës, por nuk do jetë e lehtë

DR. ASSAD HOMAYOUN*

Si mund të hartohet një politikë e vlefshme dhe e qëndrueshme në lidhje me Ukrainën, duke parë që kriza e cila ka në qendër këtë shtet mund të ketë pasoja të thella për tregtinë dhe sigurinë globale? Eshtë e qartë që duhet të injorojmë serinë e akuzave kohëshkurtëra, ose taktike që shkëmbehen mes palëve dhe të shohim perspektivën më të gjerë.

Kjo gjë nuk po bëhet në një mënyrë të paanshme, sidomos duke patur parasysh pasojat agatgjata të arkitekturës strategjike Euraziatike (dhe globale). Hapat e gabuar që hidhen në mënyrë të vazhdueshme dhe komunikimi i varfër në këtë fazë do të rezultojë në polarizime që do të provokonin veprime armiqësore të vazhdueshme.

Kriza aktuale në Ukrainë është komplekse, dhe ajo ka disa shtresëzime historike, ku mbivendosen dallimet fetarë, kulturorë, gjuhësorë, gjeografikë dhe gjeopolitikë, ashtu si edhe interesa konkurues mes tyre.

Konflikti është parashtruar në mënyrë sipërfaqësore dhe të pasaktë nga media

perëndimore dhe qarqet politikë si një agresion i paprovokuar i Rusisë kundër një qeverie ukrainase properëndimore dhe të zgjedhur demokratikisht. Ka shumë më tepër nuanca se kaq, dhe ka mjaft arsye për të fajësuar të gjithë pjesëmarrësit, sidomos ata që janë aktualisht në detyrë në Kiev - për shkak të uzurpimit në vitin 2014 të një presidenti të zgjedhur.

Në lidhje me politikën e jashtme ruse, është e rëndësishme të vërejmë se Presidenti Vladimir Putin është, në thelb, ish udhëheqësi sovjetik, Leonid Brezhnev, dhe Carët Pjetri i Madh dhe Ivani i Tmerrshëm, të gjithë të bashkuar në një. Ajo që po shohim është një dëshmi e parashikueshme, madje thelbësore, e një qasje të pandryshueshme të Rusisë ndaj identitetit dhe mbijetesës.

Politika e jashtme e Rusisë është përcaktuar gjithmonë prej gjeografisë. Dhe Rusia ka patur

gjithmonë nevojë për një zonë “sfungjer” mes “fortesës” së saj dhe Europës. Rusia dhe Europa kanë luftuar për më shumë se 450 vjet për sferat e tyre të influencës. Rusia ka vuajtur shumë pushtime nga Europa: nga Karli XII në vitin 1708, tek Napoleon Bonaparti në 1812, dhe Hitleri në 1941. Shtytja aktuale e Rusisë drejt Ukrainës është një reagim tipik refleksiv për t’u vetëmbrojtur prej zgjerimit të Europës/NATO-s. Pak më shumë se një vit më parë (dhe duke filluar më shumë se një dekadë më parë), SHBA ndihmoi për të destabilizuar Ukrainën, gjë që rezultoi me largimin në shkurt 2014 të presidentit të zgjedhur me votë, Viktor Janukovic në drejtim të Rusisë, dhe fillimin e një serie krizash të njëpasnjëshme. “Vija e kuqe” ekzistenciale strategjike e Rusisë është shkelja prej Europës e kufijve të saj, gjë që nuk e ka toleruar asnjëherë. Dhe është e rëndësishme të kuptojmë se vija e kuqe e Putinit është e ndryshme nga “vija e kuqe” që Presidenti Obama shpalli në vitin 2012, në lidhje me përdorimin e mundshëm të armëve kimike nga rusët. Situata me të cilën përballen dy udhëheqësit është e ndryshme. Për shembull, interesat e SHBA në Siri nuk ishin jetikë, ndërkohë që për Rusinë, Ukraina është ekzistenciale për interesat ruse.

Putini do të ndër marrë cfarëdolloj veprimi që të jetë i nevojshëm për sigurinë e Rusisë. Atij i duhet ta bëjë këtë për të ruajtur pozicionin gjeostrategjik të Rusisë kundrejt Europës dhe Mesdheut / Lindjes, por ai duhet të llogarisë gjithashtu edhe realitetin që, pjesa më e madhe e bazës industriale strategjike ruse ka mbetur në Ukrainë.

Kur u krijua NATO, qëllimi i saj kryesor ishte të ndalte Rusinë - atëherë Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike - që kjo të mos pushtonte Europën Perëndimore; ajo u krijua edhe për të mbajtur Gjermaninë nën frerë si dhe për të mbajtur Shtetet e Bashkuara në Europë. Në procesin e shpërbërjes së ish Bashkimit Sovjetik, Presidenti amerikan Bush, përmes Sekretarit të Shtetit Baker, i premtoi Sekretarit të Përgjithshëm të BS, Mikhail Gorbachev se NATO nuk do të zgjerohej në lindje.

Por NATO u zgjerua në lindje.

Brenda një hapësire relativisht të shkurtër kohe, anëtarësia e NATO-s u rrit nga 12 në vitin 1949, në 16 deri në vitin 1982 (dhe në fundin e Luftës së Ftohtë) arriti në 28, dhe zgjerimi ishte i gjithi drejt lindjes. Sërish i pakënaqur, Departamenti i Shtetit i SHBA e ktheu vëmendjen nga Ukraina dhe nisi ta destabilizojë. Por tashtë, kjo lëvizje shkaktoi kundërplasje.

Rusia reagoi ndaj lëvizjes më të fundit të perëndimit duke përdorur manipulimin për të rimarrë Krimenë (e cila kish qenë pjesë e Rusisë, por që ishte transferuar në Ukrainë, brenda BRSS, në vitin 1954), si dhe duke armatosur një lëvizje separatiste rusësh etnikë në Ukrainën lindore. Situata erdhi e u përshkallëzua në konflikt të armatosur.

Pas firmosjes së armëpushimit më të fundit (i treti në konfliktin aktual), ndër-mjetësuar prej kancelares gjermane, Merkel dhe presidentit francez, Hollande, i cili hyri në fuqi në 15 shkurt 2015, forcat separatiste të mbështetura nga Rusia

ia dolën të marrin kontrollin e dy vendeve me rëndësi strategjike në lindje të Ukrainës: aeroportin e Donetskut dhe nyjën hekurudhore në Debaltseve. Dhe në mesin e marsit ata ishin duke marrë edhe qytetin bregdetar me rëndësi strategjike të Mariupolit në Detin Azov, i cili është shumë i rëndësishëm për sigurinë e Krimesë.

Deri në mesin e marsit, separatistët kontrollonin një pjesë të mirë të Ukrainës lindore. Në këtë kohë, armëpushimi ende mbante, por se sa do të zgjasë, këtë askush nuk e di. Luftime të reja nisën që të raportohen përreth Mariupolit. Në një intervistë që kam dhënë në fillimin e krizës, sugjerova që një mënyrë praktike për të dalë nga kriza do të ishte “Finlandizimi” i Ukrainës. Por me rrjedhën e ngjarjeve dhe armëpushimin e ri, duket se po materializohet “federalizimi”. Një numër senatorësh të fuqishëm amerikanë, si John McCain i Arizonës dhe Lindsey Graham i

Karolinës së Jugut, ashtu si dhe think tank-et si Instituti Brookings, Këshilli i Atlantikut dhe Këshilli i Chicagos për Cështjet Globale, vazhdojnë të rekomandojnë furnizimin e Ukrainës me armë të rënda mbrojtëse. Presidenti Obama i ka refuzuar deri tani rekomandimet e tyre. Do të ishte si t’i hidhje benzinë zjarrit, sepse do të përkeqësonte një situatë edhe kështu të ndërlikuar, dhe me shumë gjasa do të shpinte në një luftë të panevojshme. Një luftë ku shanset e përdorimit të armëve bërthamore taktike do të ishin të lartë.

Tek “Arti i Luftës”, strategu kinez Sun Tzu ka thënë: Shko deri në ekstrem me përpjekjet për të shmangur luftën. Rezultati i konfliktit ushtarak nuk mund të jetë asnjëherë i sigurtë. Si pasojë, do të ishte shansi i fundit. Perandoritë shkatërrohen sepse udhëheqësit e tyre shkojnë në luftë pa arsye, apo me arsye të papërfillshme. Megjithatë, refuzimi nga Shtëpia e Bardhë i rekomandimit për furnizimin e qeverisë në atë që është, në thelb, Ukraina Perëndimore, me armë të rënda mbrojtëse, nuk duhet marrë ashtu si duket. Shtëpia e Bardhë e Obamës ka autorizuar, qysh prej vitit 2014, lëvizjen e forcave speciale amerikane në Ukrainë, duke thënë për qëllime stërvitore, por ajo ka autorizuar edhe transferimin në fshehtësi të armëve të prodhimit joamerikan për përdorim në Ukrainën Perëndimore.

Me fjalë të tjera, futja e forcave mbështetëse dhe armëve në konflikt nga ana e SHBA ka ndodhur, edhe në një kohë kur Uashingtoni ka kritikuar mbështetjen e Rusisë për forcat në Ukrainën Lindore. Është e rëndësishme të kuptojmë se Rusia është dhe ka qenë gjithmonë shumë serioze kur bëhet fjala për mbrojtjen e interesave të saj. SHBA ka interesa në Ukrainë, por ato nuk janë jetike për mbijetesën e SHBA, ndërkohë që interesi i Rusisë është jetik, madje ekzistencial. Po kështu, veprimet e Rusisë, përfshirë ata të nxitur prej udhëheqjes ushtarake të NATO-s, kanë shërbyer jo vetëm për të polarizuar marrëdhëniet SHBA-Rusi, por ata kanë larguar SHBA edhe nga shumë prej udhëheqësve në Bashkimin Europian, sidomos qeverinë gjermane.

Në të njëjtën kohë, SHBA ka një tendosje të tejskajshme për shkak të angazhimit në Lindjen e Mesme, ndërkohë që mbetet jo e vogël mundësia e rritjes së tensioneve në Detin e Jugut dhe Lindjes së Kinës. Për mua si vëzhgues, zgjidhja më e mirë për Ukrainën tani është federalizimi dhe ndoshta një detantë (ulje e tensionit) me Rrusinë, gjë e cila do të shmangte një konfrontim të madh e të panevojshëm, ose në rastin më të mirë, një vijë të re ndarëse në kontinentin Euraziatik. Por një detantë ka nevojë për një udhëheqje e llojit të Henry Kissingerit, që për momentin mungon./WorldTribune/

***Studiues, Shoqata Ndërkombëtare e Studimeve Strategjike**



Edukimi i Alexis Tsiprasit

Gjatë viteve të fundit, ish-udhëheqësi i të majtës radikale greke është bërë më i matur duke mësuar artin e kompromisit politik, përballë rrezikut të tjetërsimit të krahut të majtë të partisë së tij

Ishte një moment kyç i fushatës. Ishte një ditë e enjte në mbrëmje në sheshin Omonia, në Athinë, koha ishte e butë. Në takim të tij të fundit para votimit të 25 janarit, Alexis Tsipras, kryetar i Syrizas, do të mbante një fjalim më të fortë se sa fjalimi i udhëheqësit të Podemos, Pablo Iglesias: “Era e ndryshimit fryn në të gjithë Evropën”. Fjalë që do të kishin ndezur oreksin radikal të turmës, nëqoftëse Tsipras nuk do të mbyste ekzaltimin e mbështetësve të tij. “Ora e së majtës ka rënë!” thërriste publiku. Pa hezituat, Tsipras kishte korig-

juar: “Ora e të gjithë grekëve ka rënë”.

Pikërisht në këtë çast, metamorfoza në kryetar shteti e “agjitorit të mjatë”, që kërcënonte “të shkatërronte Euron”, siç e përshkruanin atë mediat e huaja në vitin 2012, kishte hyrë në fazën e saj përfundimtare. Prova që Tsiprasi kishte kuptuar në mënyrë progresive, javët e fundit, se po kalonte nga udhëheqës studentor në kryeministër, dhe do t’i nevojitej kompromisi politik.

Një rrugë në të cilën ai u angazhua në mënyrë të vendosur qysh të nesërmen e zgjedhjeve të qeshorit të vitit 2012. Ndërkohë që koalicioni i tij i grupeve të majta heteroklitë, me dy gishta, kishte mundur të formonte një qeveri, në Greqi, Aleksis Tsiprasi punoi për transformimin e këtyre forcave të shpërndara në një parti të vendosur nën autoritetin e tij qëndror.

Procesi arriti kulmin në kongresin e partisë në verën e vitit 2013, gjatë së cilës shumica e anëtarëve të Syriza aprovuan riorganizimin e vendosur nga kryetari i tyre. Krahu radikal i formacionit, Platforma e majtë, natyrisht ka shprehur rezerva, pa mohuar që Syriza kishte bërë shumë rrugë në shumë pak kohë dhe sepse Tsiprasi kishte ditur të dilte nga kufijtë e pejsazhit politik grek.

Beteja

Jashtë Greqisë, megjithatë, Aleksis Tsiprasi vepronte gjithashtu në konsolidimin e imazhit të tij dhe atë të partisë. Ai zhvilloi takime me të deleguarit e Fondit Monetar Ndërkombëtar, me presidentin e Bankës Qëndrore Evropiane, Mario Dragi, dhe me ministrin gjerman të financave, Wolfgang Schäuble.

Kryetari i Syriza përshkoi Evropën për të promovuar mesazhin e tij dhe për të demonstruar aftësitë e tij gjatë debateve televizive, duke iu kundërvënë kandidatëve me më shumë përvojë. Talente që do të viheshin në provë në javët e ardhshme. Një mbledhje e fundit e komitetit qëndror të Syriza zbuloi qartësisht se partia e tij nuk do t’ia lehtësonte detyrën.

Rreth 40 % e anëtarëve të këtij komiteti, të cilët kanë marrë pjesë në votim, kanë zgjedhur të mbështesin pozicionin e Platformës së majtë dhe të hedhin poshtë marrëveshjen e kohëve të fundit me Eurogrupin. Platforma gjithashtu fitoi 4 nga 11 vënde të sekretariatit politik.

Tsiprasit, betejën do të duhej ta fillonte në gjirin e partisë së tij, për ta futur Syriza në brazdën e saj. Një thyerje e pakthyeshme nuk përjashtohet.

Kështu, nëse vendimi i tij për aleancë me partinë e djathtë të grekëve të pavarur është parë keq nga shumica, por që i dha asaj një avantazh neto në skenën e brendshme politike.

Duke mbuluar një tërthore të gjerë të spektrit politik, nga e majta komuniste në të djathtë populiste, qeveria e tij ka se çfarë të federojë, por dhe çfarë të bëjë që të heshtë opozita. Është e qartë që në Greqi partitë e opozitës janë të shkëputura krejtësisht nga koalicioni dhe mbështetja e gjerë që ajo gëzon. Ato me oportunizmin e tyre ngurrojnë të sulmojnë dhe shpallin mbështetjen e tyre të negociatave, duke pritur që ato të dështojnë.

Dush i ftohtë

Ato që prisnin nga Syriza një ndryshim politik radikal në Greqi, tani duhet të presin. Pasi zgjodhi për aleatë grekët e pavarur, populistë të djathtë, Tsiprasi zgjodhi president të shtatë të Greqisë Prokopis Pavlopoulos, ish-ministër i brendshëm i Partisë Demokratike e Re.

Për ata që shpresonin se Tsiprasi do të përdorte këtë post kryesisht ceremonial për të dhënë një mesazh të fortë politik, të ndahej me të kaluarën dhe t’i ofronte opinionit mundësinë që të orientohej drejt erës së ndryshimit. Të thuash të vërtetën, asnjëherë nuk kemi besuar që ai do të nguronte të merrte një vendim i frymëzuar apo diktuar nga politika. Një pragmatizëm që u manifestua nga mënyra se si ai diskutoi për negociatat para marrëveshjes përfundimtare.

Me Eurogrupin

Ai takoi kryetarin e Eurogrupit, Jeroen Dijsselbloem, pas dështimit të mbledhjes

së dytë të ministrave të financave të zonës euro dhe ka bashkëbiseduar me kancelaren Anxhela Merkel në vigjilje të seancës së tretë dhe vendimtare të negociatave në Bruksel.

Sipas Jeroen Dijsselbloem nga kjo mbledhje e Eurogrupit më 20 shkurt, ai vetë dhe personalitete të tjera kyç të dosjes negociuan drejtpërdrejt me Aleksis Tsiprasin me telefon dhe jo me ministrin e tij të financave, Janis Varufakis, megjithëse ishte i pranishëm në Bruksel.

Natyrisht, kreditorët e Greqisë kanë ndjesinë që kryeministri është një njeri me të cilin mund të diskutosh.

Nëse fjalimet e tij në Greqi janë provokatore, ai ka dhënë prova të një maturie më të madhe gjatë daljeve të tij jashtë shtetit. Ndërkohë që ministri i tij i financave është fjalëshumë dhe i çuditshëm, Tsiprasi tregohet sigurisht këmbëngulës, por i moderuar. Në rrugën e përshkuar deri tani, ai ka dhënë prova të një shkathtësie politike që pak veta e besonin të aftë.

Por ai do të ecë në rrugën e tij si në të gjitha udhëtimet: do të jetë vetëm fundi që do të na lejojë të gjykojmë për suksesin apo dështimin e tij. MacroPolis (Athine).



Polonia, në zemër të lojës diplomatike evropiane

NGA OLIVIER DE FRANCE*

Kryeministri Manuel Valls shkoi më datë 11 dhe 12 mars ne Poloni. Cilat ishin sfidat e kësaj vizite?

Manuel Valls shkoi për vizitë në Poloni për t'u takuar me homologun e tij Ewa Kopacz dhe presidentin Bronislaw Komorowski. Sfida e parë e kësaj vizite ishte industriale. Polonia ka njohur vitet e fundit një rritje ekonomike të fuqishme, përfshirë dhe gjatë krizës ekonomike dhe financiare që kaloi Evropa. Ajo është një nga vendet e vetme evropiane që disponon sot një marzh manovre mjaft konseguent, për të investuar në mjetet mbrojtëse të saj. Polonia parashikon të shpenzojë më shumë se tridhjetë miliard euro gjatë dhjetë viteve të ardhshme për të modernizuar ushtrinë e saj, gjë që kërkon blerjen e një numri armatimesh. Refleksi i parë i polakëve kur bëhet fjalë për të zëvendësuar pajisjet e tyre të vjetëruara sovjetike është që të blejnë në Amerikë.

Prania e Manuel Vallsit nuk ishte që gjatë vizitës të avanconte këto kontrata. Ndalimi i lëvrimit Rusisë të anijeve "Mistral" është një shenjë konkrete shumë e fortë nga ana e Francës. Negociatat kanë të bëjnë me një numër kontratash afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata: helikopterë me shumë role, helikopterë sulmi dhe raketa tokë-ajër. Mbrojtja antiraketë, në mënyrë logjike lidhet me Shtetet e Bashkuara, por Franca mund të peshojë në pjesën tjetër të kontratave. Në afat mesëm, janë në lojë gjithashtu dhe nëndetëset, për të cilat grupi francez DCNS është pozicionuar. Flitet dhe për një bashkëpunim afatgjatë në fushën e centraleve bërthamore.

Në mënyrë më globale, Polonia duket shumë e preokupuar nga kriza ukrainase përse i përket sigurisë së saj. Si shpjegoni shqetësimet polake vis-à-vis Rusisë? Kjo është pjesa e dytë e udhëtimit diplomatik të Manuel Vallsit në Poloni, që lejoi të diskutohej vlerësimi i divergjencave të krizës. Duhet të vihemi në vendin e polakëve, gjë që ne në Evropën

Perëndimore nuk e kemi gjithmonë tendencë ta bëjmë. Polakët ende dhe sot kanë kujtime shumë të gjalla të racionimit të mishit, apo qeseve të sheqerit, gjatë periudhës komuniste. Ata flasin për “vëllezërit e tyre ukrainas” në anën tjetër të kufirit. Mund të flitet për një thyerje në vlerësimin nga evropianët të krizës ukrainase, midis atyre që e konsiderojnë se kriza është ushtarake, dhe atyre që e konsiderojnë që kjo krizë është politike. Polonia e sheh Rusinë si një kërcënim të sigurisë ekzistenciale të saj, duke kërcënuar interesat e saj jetike. Përtej sanksioneve të cilat janë efikase - përgjigja evropiane për krizën ukrainase është e vështirë të përpunohet në mënyrë kolektive.

Pa një dialog thelbësor mbi perceptimet dhe prioritetet strategjike, përparimet në fushën e bashkëpunimit industrial, operativ apo të kapaciteteve do të jenë të kufizuara. Polonia shqetësohet në mënyrë legjitime për atë çka ndodh në Lindje. Është e nevojshme të dëgjohet dhe të kuptohet ndjesia e tyre, dhe të nisët një dialog mbi këtë bazë. Nga ana tjetër, një numër vendesh të Evropës Perëndimore dhe të Jugut shqetësohen nga kërcënimi terrorist i atentateve të 11 janarit, të Kopenhagës në mes të muajit shkurt, të Londrës apo të Madridit.

Këto atentate bëjnë thirrje për një përgjigje globale. Ata kërkojnë një përjasje rajonale në periferinë e jugut të Evropës, nga Libia në Afrikën qendrore, nga Mauritania në Çad. Bëhet fjalë që të sulmohen rrënjët e thella të radikalizimit në brendësi dhe jashtë shoqërive perëndimore, përtej efekteve të njoftimit dhe reagimeve politike afatshkurtër, të shkaktuara nga Sharli Hebdo. Duhet në mënyrë të ndërsjellët që vendet e Evropës lindore të mund ta dëgjojnë këtë ndjesi, dhe të kuptojnë që kërcënimi terrorist nganjëherë jetohet si një kërcënim ekzistencial. Qëllimi nuk është pra të nisë një dialog shurdh, duke vënë përbri pozicione tashmë të ngurtësuara. Duhet ta zëvendësojmë me një dialog thelbësor. Duhet të dëgjojen ndjesitë respektive dhe mbi këtë bazë të gjykohet për interesat e përbashkëta. Përndryshe, ne jemi të dënur të koleksionojmë qasjet kombëtare dhe të kemi paragjykime për interesat kombëtare të vendeve evropiane. Nëqoftëse ne nuk arrijmë të flasim me polakët, ahëre ne nuk do të arrijmë të flasim me gjermanët në formatin Weimar (Poloni, Francë, Gjermani). Nëqoftëse ne nuk arrijmë të bëjmë trekëndëshin e Weimarit një forcë stërvitore për Evropën, ahëre Evropa nuk do të arrijë të stërvisë shtetet anëtare. Kjo është arsyeja që Polonia është një aktor strategjik thelbësor sot. Me një Britani të Madhe përkohësisht ose përgjithmonë e rrotulluar në Evropë, Polonia është në zemër të fushës politike pra në zemër të lojës diplomatike evropiane.

*** Studjues në Institutin e Marrëdhënieve Ndërkombëtare Strategjike, Francë**



Krimea, gozhda e fundit në arkivolin e Bashkimit Sovjetik

NGA FJODOR LUKJANOV

Një-vjetori i aneksimit të Krimesë rindezi debatin, mbi atë se çfarë do të thotë kjo për historinë e Rusisë. Ndoshta rezultati kryesor është se ajo i jep fund historisë së shtetit sovjetik. Çështja e Krimesë është ngritur që nga viti 1991, kur udhëheqësit e Rusisë, Ukrainës dhe Bjellorusisë, u takuan në Belovezhskaja Pushça në Bjellorusi, për të firmosur shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik, dhe liruuar veten kontrolli sovjetik, i personifikuar asokohe nga ish- lideri sovjetik Mikail Gorbaçov, si dhe për të fituar kontrollin e plotë mbi republikat e tyre respektive. Por ata zgjodhën të mos rrezikojnë të shqyrtojnë çështjen delikate të Krimesë, duke ia lënë atë bombë politike brezave të ardhshëm, për ta ç'aktivizuar. Ata nuk e bënë këtë dhe në vitin 2014 kriza shpërtheu, duke shkaktuar një reaksion zinxhir. Krimea

ishte një moment historik në historinë e shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik. Sado e çuditshme që mund të duket, ky territor i madh mbeti relativisht i qëndrueshëm, me disa përjashtime gjatë luftërave dhe përmbyseve të tjera. Askush nuk e ngriti seriozisht çështjen e konfigurimit të saj, pas shembjes së Bashkimit Sovjetik. Por tanimë, ideja që një ditë Krimea t'i rikthehet Ukrainës nuk është madje as në tryezën e bisedimeve. Ngjarjet e viteve 2014-15 janë akti final i një drame që filloi në vitet '80-'90. Vetëvendosja e rusëve i dha fund Perestrojkës së Gorbaçovit, si dhe përpjekjes për të reformuar Bashkimin Sovjetik. Në fakt, ky i fundit ishte i dënuar, që nga momenti kur forcat politike të Ruisë pushuan së atashuari me qendrën e këtij bashkimi.

Për këtë ka pasur disa arsye. Demokratët progresivë e cilësuan Gorbaçovin të pavendosur dhe jashtë realitetit, ndërsa reaksionarët komunistë e panë atë si një tradhtar radikal. Të gjithë donin të distancoheshin prej tij dhe dëshira e Gorbaçovit për të ndjekur një rrugë neutrale të qendrës, u provua të jetë fatale.

Me përpjekjet e tyre, republikat balltike, kaukaziane apo edhe Ukrainës, nuk mund të kenë çuar në zhdukjen e shpejtë të një vendi të tillë të madh. Ishte vetëm vullneti i lidershit të vjetër rus, të cilët u përpoqën të mbeteshin në pushtet ndërsa i kthyen shpinën Sekretarit të Përgjithshëm, dhe pastaj radha e të rinjve të etur për të marrë pushtetin, që rrëzuan perandorinë sovjetike.

Është thjeshtë e natyrshme se udhëheqësia e sotme ruse, si trashëgimtare e lidershit që i dha fund Bashkimit Sovjetik 25 vite më parë, është duke kryer hapin e radhës, duke ecur në po të njëjtin drejtim. "Bota ruse", së cilës i referohet presidenti Vladimir Putin, nuk është një përpjekje për ruajtjen e një zone ndikimi.

Përkundrazi, është një proces më shumë konceptual sesa administrativ, është përcaktimi i kufijve etnikë mendorë, që përbën një përpjekje për të përcaktuar rusët si të veçantë nga të tjerët. Vitet e fundit të Bashkimit Sovjetik u karakterizuan nga një jetë e pasur intelektuale - fillimisht gjysmë e nëndheshme dhe pastaj gjithnjë e më publike.

Projekti sovjetik ishte gjithmonë një ndërmarrje mbresëlënëse, dhe përpjekjet për transformimin e tij ishin në lartësinë e projektit. Pasojat u ndjenë në mbarë botën. Në vend, ideja e reformës shkaktoi debate aktive të çdo lloji, shumica e të cilave është ende interesante t'i lexosh edhe sot. Debatet përfshijnë shpesh herë argumente të pafundme ruse, mbi rrugën më të mirë të zhvillimit, por ata nuk ishin mendjengushtë, sepse Bashkimi Sovjetik ishte një fuqi globale dhe për këtë arsye mendohej përherë në kategori të gjera.

Kremlini besonte se duke ndryshuar gjendjen, mund të ndryshonte botën. Me rënien e Bashkimit Sovjetik, fushata ideologjike ndërkombëtare e vendit përfundoi dhe Rusia e e zhvendosi fokusin tek vetja. Udhëheqja e ristrukturuar e lidershit sovjetik ndërtoi njëfarë fytyre, duke hedhur poshtë vlerat universale të njeriut. Udhëheqësit rusë ecën nëpër një zbrazëti, duke u larguar nga çdo formë e vlerave të bazuara tek retorika.

Nuk kishte asnjë mundësi për të reflektuar menjëherë pas rënies: të gjitha përpjekjet u drejtuan drejt mbijetesës sociale, ekonomike dhe politike. Pastaj mbizotëroi pragmatizmi dhe udhëheqësit u përpoqën të riparojnë strukturën e shtetit. Kjo u pasua nga një periudhë e kërkimit, që çoi tek disa vlera - këtë herë kombëtare, në mos nacionaliste. Mirëpo, nacionalizmi është më i kufizuar në qëllimet e tij sesa vlerat universale, dhe nuk mund të tërheqë askënd përtej anëtarëve të grupit të tij të veçantë kulturor dhe etnik. Perestrojka, ishte periudha më e fundit e historisë ruse, kur vendi tërhoqi jo vetëm vëmendjen, por ofroi një "ide të madhe", duke u përpjekur të ndjellë botën me hapjen e tij të re.

Rusia post-sovjetike u përpoq në fillim të ndiqte gjurmët e të tjerëve. Ajo shpreste të integrohej në botën e ideve perëndimore, por u zhgënjye kur kjo qasje nuk i dha rezultatet e dëshiruara. Këto ankesa i dhanë hov një ideologjie mbrojtëse, të frymëzuar jo nga dëshira për të parë përtej kufijve të Ruisë, por për të

përforcuar veten kundër një bote të paparashikueshme e të rrezikshme. Në këtë kuptim, perestrojka e Gorbaçovit dhe moderniteti i Putinit gjenden në ekstreme të kundërta. Idealizmi optimist i fundit të viteve '80, është diametralisht i kundërt me realizmin e zymtë të mesit të 2010-ës. Por në të dyja epokat, interesat politike i eklipsuan konsideratat ekonomike, teksa këto të fundit nxisin propozimet jetëshkurtra për atë “që është më e mira”.

“Nxitimi” që i parapriu perestrojkës dhe glaznostit krahasohet me “modernizimin” e viteve 2008-2011. Të dyja rezultuan parulla boshe dhe shpejt u harruan. Megjithatë, mospërputhja në mes thelemeve të dobëta ekonomike të vendit dhe strukturës tepër të rëndë politike, u dëshmuua se ishte fatale për Bashkimin Sovjetik ndërsa kërcënon edhe qeverinë aktuale.

Kur Mikail Gorbaçovi u bë Sekretar i Përgjithshëm i Komitetit Qëndror të Partisë Komuniste 30 vjet më parë, në mars të vitit 1985, asokohe askush nuk mund të imagjinonte se vendi ishte në prag të konvulsioneve që do të kumbonin për dekada të tëra.

Besimi naiv që liderët sovjetikë kishin 25 vite më parë, se vendi do kryente kollaj e pa shumë probleme tranzicionin ishte i pabazë, dhe kursi zig- zag që ka ndjekur Rusia prej atëherë është pasojë e natyrshme e atyre ngjarjeve. Për fat të keq, mbetet e paqartë se përsa kohë Rusia do të vazhdojë të kërkojë rrugën e saj...

Moscow Times



Shkaqet dhe pasojat e Euros së dobët

STEPHAN KAUFMANN

Zhvlerësimi i monedhës së përbashkët shkon në avantazh të atyre që eksportojnë jashtë eurozonës. Por do të rrisë cmimet e lëndëve të para në dollarë, të udhëtimeve dhe të produkteve të importit

Tregjet financiarë janë në gjendje dehjeje: politika monetare e Bankës Qendrore Europiane po i projekton bursat drejt majave rekord, normat e interesit janë më të ulëta se kurrë ndonjëherë, ndërkohë që Euro vazhdon të zhvlerësohet. Arsyeja është quantitative easing (lehtësimi sasior) (QA), programi i blerjes së bonove nga ana e Bankës Qendrore Europiane (BQE), që po përmbyt tregjet me likuiditete. Pasojat do të ndihen edhe në jetën e njerëzve: në blerje, në udhëtime, në kursime dhe në tregun e punës.

Lehtësimi sasior nisi në 9 mars dhe do të vazhdojë të paktën deri në fundin e shtatorit 2016. Qëllimi i tij është favorizimi i rimëkëmbjes ekonomike dhe rritja e normës së inflacionit. Cdo muaj, BQE do të blejë tituj në tregjet financiarë në një

vlerë prej 60 miliardë Euro, nga të cilat 40 do u rezervohen titujve shtetërorë dhe obligacioneve të institucioneve europianë. Në 12 mars, BQE deklaroi se ka shpenzuar pothuajse 10 miliardë Euro në tre ditët e para të programit. Po cilat janë pasojat e kësaj politike?

Euro

Vërshimi i likuiditeteve që vjen si pasojë e blerjeve nga ana e BQE e bën monedhën e përbashkët më pak interesante për investitorët. Për këtë arsye, norma e saj e këmbimit reduktohet: në 12 mars, Euro ra për pak momente nën vlerën e 1.05 dollarëve, një nivel të cilin nuk e arrinte që nga viti 2003. Një vit më parë, vlera e Euros ishte 1.40 dollarë.

Zvogëlimi i normës së këmbimit favorizon eksportet e eurozonës, që mund të shiten më shumë sepse mallrat e shteteve të rajonit bëhen më pak të kushtueshëm në tregjet e huaj. Kompanitë që zgjedhin të mbajnë të pandryshuar cmimin e produkteve të tyre në monedhën e vendit ku eksportojnë, fitojnë më shumë, se sa kur i konvertojnë të hyrat e tyre në Euro. Kjo tendencë ka efekte pozitive mbi konjunkturën ekonomike. Blerja e titujve, shpjegon Stefan Bielmeier, krye-ekonomist i Dz Bank, është “një turbo për rritjen ekonomike gjermane”. Commerzbank, banka e dytë më e madhe e Gjermanisë, i ka korrigjuar parashikimet e saj për rritjen e ekonomisë gjermane për vitin 2015, nga 1.5 në 1.8%, kryesisht për shkak të dobësimit të Euros.

Në Shtetet e Bashkuara, kompanitë eksportuese penalizohen prej dollarit të fortë, që i bën produktet e tyre më të kushtueshëm në tregun global. Në fund të fundit, pesëqind kompanitë kryesore të kuotuar në bursën amerikane, ato që formojnë S&P 500, arkëtojnë pothuajse një në tre dollarë, jashtë Shteteve të Bashkuara. Konjunktura pozitive do të krijojë vende pune në Europë. Por në të njëjtën kohë, konsumatorët do të kenë disavantazhe: udhëtimi jashtë, për shembull në SHBA, në Zvicër apo në Mbretërinë e Bashkuar, do të bëhet më i kushtueshëm. Rritja e cmimeve mund të ndikojë edhe mallrat e importit. Kafeja, një lëndë e parë e vlerësuar në dollarë, që tani është bërë më e kushtueshme. Edhe produktet industriale dhe ata të konsumit me prejardhje Azinë (ku monedhat e shumë vendeve janë të lidhura me dollarin) mund të pësojnë një shtrenjtim. Megjithatë, në Gjermani këta efekte me shumë gjasë do të zbuten prej rritjes së konkurrencës në tregtinë me pakicë. Po kështu, konsumatorët gjermanë mund t’i bëjnë ballë rritjes së cmimeve falë faktit që paga e tyre do të pësojë një rritje pakëz të qëndrueshme, në krahasim me atë të konsumatorëve të Europës jugore, ku papunësia i mban pagat e ulëta. Sido që të jetë, një shtrenjtim i produkteve të importit në Gjermani nuk do të ishte shumë negativ, sepse cmimet e këtyre produkteve janë në rënie, që nga fundi i vitit 2012, e si pasojë ngarkesa mbi konsumatorët është zvogëluar në mënyrë konstante.

Normat e interesit

Ndërkohë që BQE po shpenzon miliarda për të blerë tituj shtetërorë dhe obligacione në eurozonë, oferta e këtyre instrumentave financiarë po tkurret: vendet e Bashkimit Europian nuk emetojnë më shumë tituj shtetërorë për të blerë para në tregje. Po kështu, një pjesë e madhe e këtyre titujve është tashmë në duart e bankave dhe sigurimeve, që ndoshta do të zgjedhin të mos i shesin në masë tek BQE, sepse duan t’i mbajnë për vete, apo sepse do të duan ta bëjnë mbi bazën e normave të sektorit të tyre. Rritja e kërkesës për tituj përballet, pra, me një ofertë të kufizuar. Rezultati është që rendimentet reduktohen. Norma e interesit e titujve shtetërorë gjermanë me një afat maturimi dhjetë vjet është 0.2 përqind, dhe vlera e atyre italianë ka rënë në 1.15 përqind. Titujt e Portugalisë po shkojnë drejt 1.6 përqindëshit, më pak se sa paguajnë SHBA apo Mbretëria e Bashkuar. Kjo tendencë favorizon në mënyrë indirekte edhe tatimpaguesit.

Ndërsa për ata që kursejnë, kjo nënkupton që investimet e sigurtë nuk janë fitimprurës, madje mund të shndërrohen në një kosto. Sot, titujt shtetërorë të Gjër-

manisë, me maturim deri shtatë vite kanë një rendiment negativ. E njëjta gjë vlen për ata francezë, deri në katër vjetarë. Kush blen këtë lloj titujsh, arkëton më pak nga sa investon. Huamarrësit janë të vetmit që përfitojnë prej uljes së normave të interesit: sot, për një hua me kohëzgjatje 15 vite paguan më pak se 2 % të interesave.

Aksionet

Ajo që i shqetëson kursimtarët, gëzon aksionerët. Politika e Bankës Qendrore Europiane po prodhon në fakt një rritje të vazhdueshme të tregjeve të aksioneve. Që nga fillimi i vitit, indeksi i bursës gjermane, Dax, është rritur me 20%, ndërkohë që indeksi europian Euro-Stoxx50 është rritur me 16%. Dow Jones, indeksi i bursës së Wall Street-it, ka regjistruar një rënie me 1%. Paraja e hedhur në qarkullim nga Banka Qendrore Europiane po derdhet pjesërisht edhe në tregjet e aksioneve, edhe sepse titujt shtetërorë dhe obligacionet nuk prodhojnë më rendimente të lartë, ndërkohë që kompanitë e kuotuar në Dax mund të nxjerrin ende dividendë prej 3%. Por, situata është e paqëndrueshme: “Kjo rritje e vlerës së aksioneve nuk është e shëndetshme”, ka paralajmëruar Dz Bank në 12 mars. Kuotimet po shkojnë drejt “teprimeve të rinj spekulativë”.

Frankfurter Rundschau



Në të ardhmen e Evropës së Putinit

NGA DAVID IGNATIUS

Gjuha e Luftës së Ftohtë është rikthyer me hakmarrje, përmes një të folure të përtërirë të alarmit bërthamor, testimi të pretenduar të raketave me rreze të mesme bërthamore, dhe shqetësimeve mbi sistemin mbrojtës raketor të NATO-s. Aneksimi i Krimesë nga presidenti Vladimir Putin, pak më shumë se një vit më parë, është zgjeruar tashmë në atë, që disa zyrtarë amerikanë e shohin si një sfidë më të gjerë ruse, ndaj rendit të pas-Luftës së Ftohtë.

Lajmet e kohëve të fundit, tingëllojnë të tilla a thua se marrëdhëniet SHBA-Rusi, janë katandisur sërish drejt rrezikut të përballjeve vdekjeprurëse të viteve '80. Debatimi mbi agresionin rus, nuk është vetëm për Ukrainën. Aktivitetet e Putinit, kanë rindezur shqetësimet kryesore, që krijuan në fakt aleancën e NATO-s. Për fat të keq, këtë herë, duket se ka më pak zgjidhje trans-atlantike, për të luftuar kërcënimet që vijnë nga Moska.

Administrata Obama, po debaton aktualisht si të përforcojë politikën e saj ndaj Ruisë, por ka qartazi mosmarrëveshje të brendshme. Sekretari i Mbrojtjes, Eshton Karter dhe gjenerali Martin Dempsey, kryetar i shefave të përbashkët, duket se favorizojnë dërgimin e armëve vdekjeprurëse në Ukrainë. Por presidenti Obama, duket i mbërthyer mes dëshirës për të përmbajtur veprimet ruse, dhe shpresës të tij të vazhdueshme për bashkëpunimin e Moskës, si për bisedimet për programin bërthamor të Iranit, ashtu edhe dhënies fund të luftës civile siriane. Një shembull i gjallë i kohës së Luftës së Ftohtë, ishte zbulimi i Putinit në një dokumentar rus fundjavën e kaluar, se ai po e merrte seriozisht në konsideratë, vënien në gatishmëri të forcave bërthamore ruse në fillim të vitit të shkuar, kur Rusia ndërhyri në Krime, pasi qeveria proruse e Kievit u rrëzua.

Komenti i tij, dëshmoi sërish rrezikun që konflikti në Ukrainë, mund të rezultojë një spirale jashtë kontrollit. Si një shenjë e kohëve të errëta, Rusia njoftoi të

martën, sesi pjesë e një ushtrimi luftarak, do të dërgonte raketa të avancuara në enklavën e saj balltike të Kaliningradit dhe bombardues bërthamorë në Krime. Procesi i kontrollit të armëve, që garanoi mbajtjen nën kontroll të Luftës së Ftohtë, tani duket të jetë në drejtimin e kundërt. Rusia u tërhoq javën e kaluar nga konsultimet rreth Forcave Konvencionale, sipas Traktatit Evropian të vitit 1990, duke sinjalizuar se efektivisht ka ndërmend ta braktisë këtë pakt.

Moska ka bllokuar edhe diskutimet, mbi ndonjë shkurtim shtesë tek arsenali i armëve bërthamore, i parashikuar nga traktati “Neë STRART” në vitin 2010. Por avaria më shqetësuese në tensionet SHBA-Rusi, mund të jetë shpërbërja e Traktatit të vitit 1987, mbi paktin qeveritar të forcave bërthamore për raketat me rreze të mesme në Evropë, i njohur si Traktati INF.

Korrikun e kaluar, Shtetet e Bashkuara e akuzuan Rusinë për shkeljen e këtij pakti, pas testimi në terren të raketave, që shkelnin kufijtë, mbi të cilët ishte rënë dakord. Rusët kundërshtuan, duke hedhur akuzar rreth shkeljeve të supozuara të SHBA-së. Karter, paralajmëroi në raportimin e tij në Kongres muajin e kaluar, se Shtetet e Bashkuara do të konsiderojnë opsionet ushtarake, në rast se Rusia nuk do të rrikthehej të respektonte traktatin INF. Këto masa mund të përfshijnë “mbrojtjen aktive”, për të ndaluar raketat bërthamore dhe “aftësitë goditëse kundërvepruese”- tha ai.

Rrëzimi i mundshëm i marrëveshjes INF, është veçanërisht i rëndësishëm, për shkak se ajo ishte një hap vendimtar drejt dhënies fund të Luftës së Ftohtë. Traktati u negociua, pasi Shtetet e Bashkuara dhe aleatët e saj evropianë, vendosën t’i kundërpërgjigjen vendosjes se raketave bërthamore ruse SS-20, duke instaluar raketa të ngjashme Pershing në Evropë.

Ky hap bëri që lideri sovjetik Mikail Gorbaçov të ndalojë planin e raketave SS-20 dhe të nënshkruajë traktatin, duke inkurajuar atë që Putin e sheh tashmë si epokën e dobësisë dhe humbjes ruse. Ndërsa Putin ka ecur drejt rivendosjes së prestigjit të Rusisë, ai ka përdorur taktika të tilla si armatosja e separatistëve në Ukrainën Lindore, të cilat janë më afër operacioneve të inteligjencës sesa veprimet ushtarake konvencionale. Kjo qasje, e quajtur si “lufta hibride” nga analistët perëndimorë, ka mbuluar me turp Shtetet e Bashkuara dhe aleatët e saj të NATO-s. Ata deri më tani, kanë hezituar t’i japin Ukrainës armë vdekjeprurëse, që të mund të luftojnë si duhet forcat e armatosura rebele, të mbështetura nga Rusia. Ukraina nuk është një anëtare e NATO-s, dhe Shtetet e Bashkuara u përpoqën ta bënin të qartë, që në fillim të krizës se do të përdorin forcën ushtarake, për të penguar një agresion të ngjashëm kundër një anëtari të NATO-s, në bazë të nenit 5 të traktatit të aleancës. Por angazhimi për t’u hakmarrë ndaj sulmeve nga jashtë, ngre pyetjen sesi NATO do t’i përgjigjet subversonëve si ai në Ukrainë, kundër “burrave me të gjelbër” të mbështetur nga forcat ruse. Për shembull, nëse separatistët rusisht-folës, do të pushtojnë territorin e një vendi Balltik, a do të godasë NATO Rusinë? Të papritura të tilla, duan më shumë diskutim. Për më tepër a ka ende NATO “muskujt” e mjaftueshëm ushtarakë, për të përshtatur një përgjigje efektive, duke e marrë të mirëqenë se e ka vullnetin politik?

Shtetet e Bashkuara, kanë pakësuar forcat e saj në Evropë, sidomos në pjesën ku për një kohë të gjatë ishte brezi kufitar i Luftës së Ftohtë. Ndërkohë vetë kombet evropiane, të hutuara nga kriza ekonomike, nuk kanë përmbushur premtimin për të shtuar forcat e tyre ushtarake. Edhe Britania, tradicionalisht aleati më i fuqishëm i Amerikës në NATO, nuk ka përmbushur objektivin e shpenzimeve të mbrojtjes, të vendosur vitin e shkuar në samitin e aleancës në Uells.

Është pra një rrikthim në të ardhmen e Evropës së Putinit. Por muskujt e dikurshëm që parandalonin, duket se janë atrofizuar. Ka kaluar shumë kohë, qëkur NATO është vënë realisht në provë, aq sa anëtarët e aleancës, mund të ketë harruar se çfarë do të thotë në fakt vetë-mbrojtje kolektive./“**Uashington Post**”/



Ditët kur BE po “vdes”

NGA DIRK SCHUMER

Berlin - Greqia vs Gjermanisë: Çfarë drame! Çdo skenarist në Hollivud do të gjen-te kënaqësi tek brutaliteti i kësaj martesë të veçantë. Njëra akuzon për mashtrime dhe vjedhje, tjetra përgjigjet me thirrje për shlyerjen e borxhit të Luftës së Dytë Botërore dhe dëmshpërblimet. Flamuj gjermanë dhe foto të kancelares Merkel janë djegur publikisht. Shaka mizore qarkullojnë mbi jugun e zhytur në borxhe, me vizitat e politikanëve nga veriu që kërkojnë masa të shtuara sigurie.

Si do të përfundojë e gjitha kjo?

Për fat të keq, e gjitha kjo nuk është ushqim për një skenar imagjinar, por një realitet politik në Evropë, që nga viti 2008. Duket se ndërsa po luhet kjo dramë agresive martesore, protagonistët e saj janë të pashqetësuar se sa shumë dëm i është bërë themeleve të Bashkimit Evropian. Por a ka diçka që ka mbetur nga rrënojat e së kaluarës?

Kur ideja evropiane mori formën e saj të bukur dhe potencialisht shëruese pas vitit 1945, ajo realisht u ndërtua mbi rrënojat e luftës. Askund tjetër në botë nuk kishte terren më të përbashkët evropian, sesa në Aushvic, ku njerëzit e të gjitha

kombësive evropiane ishin vrarë.

Mes gërmadhve nga Kaena në Nuremberg, nga Roterdami në Milano, luftërat kombëtare të të gjithëve kundër gjithë të tjerëve, të cilat patën shpërthyer në Evropë që prej rënies së Perandorisë Romake, ishin për t'u hedhur mbi koshin e plehrave të historisë. Unioni mendohej se ishte një ledh mbrojtës kundër Bashkimit Sovjetik anti-demokratik, dhe pragmatizmi ekonomik një kurë për të gjithë. Në vend të Napoleonit, Bismarkut apo Hitlerit, ishin politikanët veteranë të butë e të urtë, kryesisht katolikë, si Konrad Adenaueri, Charl de Goli dhe Alçide de Gasperi, të cilët ia dolën që të zgjidhnin problemet ndërkombëtare me formimin e komisioneve të reja. Dalëngadalë, por me siguri, edhe plagët më të këqija të së kaluarës më në fund filluan të mbyllen dhe u bënë plagë më të vogla, dhimbjet e të cilave ishin të durueshme, pa patur nevojë që sovraniteti kombëtar të vihej ndonjëherë në diskutim.

Evropa nuk ishte e vendosur haptaz, por arriti fshehurazi në marrëveshje mbi debatet rreth parimeve themelore. Por diçka duket se shkoi keq në fabrikën e kompromiseve të formuara në Bruksel, Luksemburg dhe Strasburg. Më vonë, historianët mund të identifikojnë si pikë kthese futjen e monedhës së përbashkët Euro (1998- 2001) dhe përpjekjen e dështuar të vitit 2005, për të miratuar një Kushtetutë të përbashkët evropiane.

Me një monedhë të përbashkët dhe kushtetutë, projekti i mijëvjeçarit dukej i përcaktuar të ishte i lidhur mjeshtërisht dhe të kurorëzohej me lavdi. Edhe pse Euro dështoi vetëm në rastin e ndihmës financiare ndaj Greqisë, kushtetuta evropiane "vdiq" para se të mund të merrte krahë, kur ajo u hodh poshtë nga kombet evropiane themeluese të unionit, si Franca dhe Holanda.

Nëse BE-ja është parë si një treg i përbashkët, duke bashkur atë që mundej, Euro ka kontribuar në këtë fatkeqësi në krijimin e një centrifuge sociale. Madje po ndodh edhe më keq: mangësitë demokratike që ishin toleruar për shkak të avantazheve të një tregu të përbashkët dhe kufijve porozë, janë bërë tashmë të padurueshme për qytetarët e BE-së.

Vrima e zezë, që dikur ishte përgjegjësi evropiane, ka gëlltitur kontratat ligjore sa i përket rregullimeve të borxhit kombëtar. Kredo të tilla si liria e udhëtimit dhe trajtimi human i refugjatëve janë fenomene që tani kanë më pak rëndësi, nga Britania e Madhe deri në Greqi. Ajo që dikur e qanim fryma evropiane është asgjësuar përgjatë gjithë procesit.

Athina, sjellje prej Putini

Por nëse kjo nuk është aq e frikshme sa duhet, bastionet e fundit të mirësjelljes ndërkombëtare janë shkatërruar, pas dekadash të një tregu të përbashkët dhe ligjeve të përbashkëta. Zyrtarët grekë, të udhëhequr nga kryeministri Aleksis Cipras, po kërkojnë dëmshpërblime që datojnë që nga Lufta e Dytë Botërore dhe kërcënojnë se do t'u mundësojnë terroristëve islamikë të udhëtojnë për në Berlin, duke i lejuar emigrantët e paligjshëm në Greqi të udhëtojnë drejt veriut, në rast se eurozona vazhdon që t'i imponojë politika shtrënguese.

Edhe presidenti rus Vladimir Putin nuk ka shkuar kaq larg. Në marrëdhëniet ndërkombëtare, nuk ka kurrë një fatkeqësi të përbashkët sociale, që trajtohet me më shumë cinizëm dhe shpifje. Tashmë është koha kur metodat e mirë-praktikuarra të demokracisë në Gjermani duhet të japin frytet e veta: një thirrje e ambasadorit grek, një deklaratë parlamentare dhe diskutim në Berlin, kundërmasat e marra, llogaritjet e publikuara publikisht dhe bilancet, dhe një deklaratë në lidhje me pozicionin gjerman.

Por ndonëse çdo qytetar ka të drejtë për përfaqësimin e duhur, kjo degë e veçantë e politikave kombëtare është joekzistente brenda makinerisë së taktikave të BE-së. Nuk ka debat, as padi ndërkombëtare, asnjë sqarim. Bashkimi Evropian ka dështuar, përderisa dy shtete urrejnë njëri-tjetrin. A mund të gjendet ende ndonjë bazë e përbashkët evropiane?

Diktatorë si politika

I njëjti arsytim ka bërë që shumë grekë të pyesin nëse institucionet evropiane ishin në gjumë kur u fut monedha e përbashkët evropiane. Nuk kishte vallë asnjë seksion brenda Bankës Qëndrore Evropiane, që mund të shqyrtonte me detaje bilancet greke? Çfarë bënin diplomatët gjermanë në Athinë, kur mesa duket nuk pati raportime të dërguara në Berlin në lidhje me partnerin krejtësisht jo të besueshëm financiar, sikurse ishte Greqia asokohe? Ndoshta e gjithë kjo është dashur të zhduket në kënetat e errëta të zyrave të BE-së?

Kancelari gjerman në vitet 1982-1998, Helmut Kol tha në vitin 2002 se ai e kishte futur Euron “si një diktator”. Dhe ky duket kështu ka qenë. Në një diktaturë, qytetarët nuk kanë të drejtë të kërkojnë që qeveria e tyre të justifikojë veprimet e saj, sidomos kur 369 miliardë Euro kërkohen nga Gjermania në formën e dëmshpërblimit për Luftën e Dytë Botërore, kur prona e tyre është në rrezik për t’u konfiskuar, apo edhe kur aktet e terrorit janë përdorur si një këst kundër tyre. Eksperimenti evropian i pasluftës është më në krizë se kurrë më parë. Çfarë lloj bashkimi është ai, ku askush nuk merret vesh me njëri-tjetrin? A është gjendja kaq e çoroditur, saqë në këtë fazë, një divorc i ndershëm dhe ndarje e aseteve është i pamundur?

Zgjedhjet më të fundit për në Parlamentin Evropian rezultuan me fitoren e partive të së djathtës ekstreme dhe së majtes ekstreme, që fituan një numër rekord vendesh. Por nuk është për t’u çuditur. Qytetarët e BE-së janë thjesht më të shqetësuar për sigurinë e vendit të tyre, sesa mbi atë të konfederatës së shteteve. Aty ku e tashmja dhe e ardhmja duket e zyrtë, nostalgjia lulëzon në mënyrë natyrale. Pikërisht këtë neo-patriotizëm duhej të zbehte Bashkimi Evropian. Në fakt nuk është bërë asgjë për t’u përballur me këtë fenomen.

Shkatërrimi i Ukrainës dhe peisazhet e rrënuara të ish-Jugosllavisë dëshmuuan një urrejtje që vlon në vetvete, në një konfederatë të dobët shtetesh. Edhe pas 70 vjetësh pasi Traktati i Romës promovoi atë që do të bëhej më vonë BE, një brez i njerëzve të projekteve të mëdha të Evropës bëjnë gabime trashanike dhe manipulime me borxhet dhe politikat e kursimit. Por në momentin kur njerëzit të kuptojnë se çfarë katastrofe i pret nëse shpërbëhet BE-ja, do të jetë shumë vonë.

/“Die Welt”/



KOHA E HILARISE A do e “thyejë tavanin e xhamtë”?

NGA LUCY WALLIS

Hilari Klintoni ka bërë tashmë me dije se do të kandidojë për t’u zgjedhur presidente e SHBA në vitin 2016. Gjatë gjithë karrierës së saj, ajo ka përdorur pozitën për të mbrojtur të drejtat e grave në mbarë botën. Duke folur për BBC, 3 prej udhëheqëseve më të fuqishme në historinë e viteve të fundit, reflektojnë mbi atë që është arritur deri më tani.

“Unë e dua (ish-sekretaren amerikane të Shtetit) Madlen Ollbrajtin, tashmë shumë e njohur përmes deklaratës së saj, se ka një vend të veçantë në ferr për gratë që nuk ndihmojnë gratë e tjera, pasi ka ende aq shumë punë për të bërë” - thotë Hilari Klintoni. Si Zonja e Parë e Shteteve të Bashkuara, në vitet 1993-2001 dhe ish- sekretare e shtetit në vitet 2009-2013, zonja Klinton është e vetëdijshme për përgjegjësinë e saj të vazhdueshme, si një përfaqësuese e grave në të gjithë botën.

“Në shekullin e XXI-të, pjesa më e madhe e punës është e papërfunduar. Është e

drejta dhe mundësia e plotë për gratë dhe vajzat, dhe kjo është ajo ku ne duhet të përqëndrohemi” - thotë ajo. Gjithashtu Klintoni ka një çështje të papërfunduar, kur është fjala edhe për presidencën e SHBA. Në vitin 2008, ajo ishte në anën e gabuar të historisë, në garën e saj për zgjedhjet presidenciale, duke humbur ndaj rivalit brendapartiak, Barak Obama.

“Ideja e garimit për presidente si një grua, ishte një hap i bazuar tek besimi, ndonëse disa gra kanë provuar në të kaluarën, por askush prej tyre nuk pati shkuar aq shumë larg” - shprehet Klinton. “Unë isha gruaja e parë, që fitova të gjitha garat paraprake, dhe pastaj fitova pothuajse 18 milionë vota” - shton ajo. Kur Obama fitoi nominimin, Klintoni më në fund foli për rëndësinë historike që do të kishte zgjedhja e një gruaje në Shtëpinë e Bardhë, gjatë fjalimit të saj ku pranonte humbjen përballë Obamës: “Edhe pse këtë rradhë nuk qemë në gjendje të thyenim tavanin më të lartë prej xhami, falë jush krijuam rreth 18 milionë të çara në të” - tha ajo. Çarjet në nivelin më të lartë, fillojnë të shfaqen vetëm kur ka presion dhe rezistencë nga poshtë. Si Zonjë e Parë, Klinton vendosi një sfidë për të gjithë botën, ngritjen e profilit dhe të drejtat e grave dhe barazinë e femrës në çdo vend, kur foli në konferencën e katërt ndërkombëtare të OKB- së mbi gratë në Pekin, në vitin 1995. Hilari deklaroi se “të drejtat e grave, janë të drejtat e njeriut”, ajo diskutoi sesi këto të drejta janë shkelur sa herë një fëmijë është mbytur, vetëm sepse ka lindur femër.

Ajo foli ndërkaq për brutalitetin e gjymtimit gjenital femëror, trafikimin seksual dhe sesi trupat e grave ishin shndërruar në një front lufte, ku përdhunimi gjithnjë e më shumë po përdorej si një taktikë në betejë.

Madlen Olbrajt, e emëruar e para grua në postin e sekretares së shtetit në SHBA-së në vitin 1997, pati një axhendë të ngjashme. Ajo trajtoi të drejtat e grave, gjatë gjithë kohës që mbajti postin e ambasadores amerikane në OKB në vitet 1993-1997, por si një nga 7 përfaqësueset e përhershme gra, ajo solli vëmendje në çështje të tilla si vuajtjet e grave në konfliktin boshnjak. “Unë do të shkoj në mbledhje dhe flas për rëndësinë e mbështetjes së Bosnjes, dhe disa burra rreth tryezës do të thonë: mos ji kaq emocionale” - tha ajo. Por duhej të vinte viti 2000, kur u miratua Rezoluta 1325 në OKB që pranonte rolin e gruas në luftë. Ajo ishte në fakt rezoluta e parë e OKB-së, që përmendte në mënyrë specifike gratë dhe u pasua nga dy rezoluta të tjera, të cilat deklarorin se përdhunimi dhe sulmi seksual ishin krime lufte. Si sekretarja e dytë grua e shtetit, në shërbim në vitet 2005-2009, Kondoleza Rajs gjithashtu përkrahu të drejtat e grave. Gjatë luftës në Afganistan, ajo solli në vëmendjen e botës trajtimin çnjerëzor që talebanët u bënin grave, duke mos kërkuar asnjë falje apo pranuar ndonjë kritikë. “Ne harxhuam gjakun dhe pasurinë e amerikanëve për të çliruar popullin e Afganistanit, nga një prej regjimeve më brutale mbi faqen e dheut. Që ne ta përdorim këtë moment për të shtypur të drejtat e grave, mua më duket e pamendueshme. Dhe kështu natyrisht ishim të ashpër lidhur me këtë çështje. Ajo është një shoqëri tradicionale, që duhet të përqafojë standartet e shekullit XXI-të për gratë” - tha ajo.

Si Sekretare e Shtetit, Rajs thotë se nuk hasur kurrë një situatë në të cilën ajo të jetë trajtuar ndryshe, për shkak se ishte një grua. “Ju them sinqerisht, se si sekretare e shtetit nëse dikush ju trajton keq dhe kjo ndodh sepse ju jeni një grua, ky është faji juaj dhe jo i tyre. Ju keni shumëçka në dorë dhe nëse ju ndonjëherë vëreni se dikush vë në pikëpyetje autoritetin tuaj, atëherë duhet të bëni pikërisht atë që duhet bërë, pra duhet ose vazhdoni të punoni me atë person, ose duhet ta pushoni nga puna. Unë i kam bërë të dyja”.

Gratë në pushtet

Nëse Klintoni do të zgjidhet presidente, ajo do të hyjë në një klub të vogël të lidereve gra, duke përfshirë: Angela Merkelin, kancelaren e parë grua të Gjermanisë. Merkelin u cilësua vitin e shkuar si gruaja më e fuqishme në botë nga revista “Forbes”.

Kristina Fernandez de Kirshner, presidentja e parë femër e Argjentinës. Ajo krahasohet shpesh me legjendaren Eva Peron. Dilma Rusef, presidentja e parë grua e Brazilit. Rusef, e cila u bë e famshme për kritikën e ashpra publike ndaj ministrave të saj.

Pra, çfarë bëjnë këto gra që të ndihen të arrira kohët e fundit? “Unë mendoj se kjo është arritur qëkur Pekini, e ka pranuar se kjo është diçka që duhet bërë - thotë Ollbrajt. “Tani kjo nuk duket një punë e madhe, por nëse e kuptoni se kemi përsë hkuar qindra vite ku çështjet e grave cilësoheshin si anësore ose sentimentale, ndërsa sot janë çështje në qendër të politikës së jashtme”.

Numri në rritje i grave në pozita drejtuese në botën e zhvilluar dhe në zhvillim, është një shenjë inkurajuese, sipas Rajs. Ollbrajt thotë se shoqëria është më e qëndrueshme, nëse gratë fuqizohen politikisht dhe ekonomikisht. “Gratë duhen të zgjohen në ato pjesë të botës, ku kjo gjë nuk ka ndodhur, dhe duhet të luftojnë për të drejtat e tyre”-thotë Rajs.

Ndërkaq për Hilari Klintonin, çdo progres lidhur me të drejtat e grave, ka qenë i ngadalshëm. “Ne kemi ende shumë shumë për të bërë, dhe gjithësesi mos t’i sh-mangemi përgjegjësive, pa marrë parasysh se çfarë po ndodh në botë, ne duhet të vazhdojmë në këtë axhendë” - thotë ajo. Vetëm koha do të tregojë nëse kjo axhendë do të ndihmojë ndërkaq edhe garën e Klintonit drejt Shtëpisë së Bardhë, duke shkatërruar kështu tavanin e xhamtë. /BBC/



Pse amerikanët urrejnë të bisedojmë me armiqtë?

NGA DOMINIC TIERNEY*

Kundërshtimi i ethshëm i republikanëve, ndaj një marrëveshje mbi programin bërthamor të Iranit, mund të duket si një shembull tjetër i politikës partiake dhe armiqësisë personale ndaj Barak Obamës. Por ka ndërkaq një arsye shumë më të thellë për përplasjen në Kongres: neveria e thellë, e rrënjosur në kulturën amerikane, për të folur me kundërshtarët e “ligj”.

Negocimi me kundërshtarët ndërkombëtarë është më i debatueshëm në Shtetet e Bashkuara, sesa në shumë demokraci të tjera të zhvilluara. Ndërsa në vende të tjera pazarllëqet shihen shpesh si normale, amerikanët jo rrallë i shohin bisedimet ballë për ballë, si një çmim që kundërshtari duhet ta fitojë vetëm përmes sjelljes së mirë. Shtetet e Bashkuara janë pjesë e një koalicioni prej 6 vendesh që po diskutojnë me Iranin, së bashku me Britaninë, Francën, Rusinë, Kinën dhe Gjermaninë.

Por SHBA-ja është i vetmi vend ku marrëveshja ka gjeneruar një stuhi politike në politikën e brendshme. Rezistenca ndaj një marrëveshje me Iranin është pjesë e një historie të gjatë skepticizmi amerikan, përsa i përket marrjes vesh me kundërshtarët.

Gjatë viteve të para të Luftës së Vietnamit, Franca, Britania, Kanadaja, dhe Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, iu lutën Uashingtonit të negocionte fundin e konfliktit, por SHBA refuzoi nënshkrimin e çfarëdolloj armëpushimi, përveç alternativës së dorëzimit pa kushte të Vietnamit të Veriut.

Më afër në kohë, në vitet 1990, republikanët sulmuan përpjekjet e presidentit Bill Klinton për të negociuar një marrëveshje bërthamore me Korenë e Veriut, me senatorin Xhon Mekein që e quajnte procesin e bisedimeve të barazvlefshëm me “pajtimin” me Phenianin.

Në vitin 2003, kur Iraku nisi të rrëshqasë drejt kaosit, zv.sekretari amerikan i Mbrotjtjes, Pol Volfovic mori një memo që sugjeronte se Shtetet e Bashkuara duhet të bashkëpunonin me sunitët e pakënaqur. Thuhet se ai u përgjigj me 3 fjalë: Ata janë nazistë!

Në vitin 2008, presidenti Xhorxh W. Bush deklaroi para Knesetit izraelit: “Disa, duket se besojnë që ne duhet të negociojmë me terroristët dhe radikalët, a thua se disa argumenta të mençura do t’i bindin ata se e kanë patur gabim. Por kjo ulje në bisedime do të ishte vetëm një “rehati e rremë e pajtimit”.

Për një dekadë pasi Shtetet e Bashkuara e pushtuan Afganistanin, nga Bushi tek Obama refuzuan të hyjnë në bisedime me kryengritësit talebanë. Një rishikim i strategjisë së SHBA në vitin 2009, madje as nuk e konsideronte mundësinë e një zgjidhje diplomatike me udhëheqjen talebane. Në vitin 2010, Përfaqësuesi i posaçëm i SHBA për Afganistanin, Riçard Hollbruk e pyeti gjeneralin Dejvid Petreus për pajtimin afgan. “Riçard, kjo është biseda e disatë mbi këtë çështje” - thuhet se u përgjigj Petreus. “Po, është e mundur. Por jo tani”. Më vonë, gjatë fushatës presidenciale të vitit 2012, kandidati republikan për president, Mit Romni deklaroi: “Ne s’duhet të negociojmë me talebanët, ne duhet t’i mposhtim ata”.

Rezistenca ndaj angazhimit diplomatik është zakonisht më e fuqishme në krahun e djathtë. Për shembull, në vitin 2013, 27 përqind e demokratëve nuk e miratuan nënshkrimin e një marrëveshje të përkohshme me Iranin mbi programin e tij bërthamor, krahasuar me 58 përqind të republikanëve.

Presidentët demokratë janë veçanërisht të prekshëm ndaj akuzave si “pajtues”, për të biseduar me armiqtë. Përkundrazi, është shpesh politikisht më e lehtë për republikanët agresivë për të negociuar, pasi pak vetë mund të dyshojnë tek rezistenca e tyre.

Gjatë Luftës së Ftohtë ishin presidentët demokratë ata që filluan luftërat e mëdha në Kore dhe Vietnam. Ndërsa presidentët republikanë biseduan sipas mënyrës amerikane. Sikurse ka mbetur si shprehje, ajo rrugë e çoi Niksonin në Kinë.

Por përse amerikanët nuk pëlqejnë të negociojnë me armiqtë e tyre? Përgjigja ka të bëjë me kombinimin e fuqisë dhe moralizmit të vendit. Pas vitit 1945, Shtetet e Bashkuara u shfaqën në botë si një kolos me një ekonomi tre herë më të madhe se konkurenti i tij më i afërt, Bashkimi Sovjetik. Aftësitë e SHBA për të ruajtur rendin global e zvogëluan nevojën e dukshme për kompromis me kundërshtarët më të dobët si Vietnamit të Veriut, të cilin Lindon Xhonsoni e etiketoi “vend zhelan i rangut të katërt”.

Ndërkohë, sipas një tendosje moraliste në kulturën amerikane, kompromisi me kundërshtarët “e ligj” njollos vlerat e SHBA. Amerikanët kanë prirjen të jenë thellësisht të përkushtuar ndaj idealeve të kombit, demokracisë, dhe të drejtave individuale. Niveli i besimit fetar është gjithashtu shumë më i lartë në Shtetet e Bashkuara, sesa në demokracitë e tjera të pasura.

Për pasojë, amerikanët ka shumë të ngjarë të thonë se kanë standarde absolute për të mirën dhe të keqen, ndërsa evropianët, kanadezët, dhe japonezët, me shumë gjasa do të shpreheshin se etika varet nga rrethanat.

Drejtësia e moralit amerikan mund ta bëjë aktin e bisedimeve të duket natyrshëm i dyshimtë. “Sepse ne luftojmë për vlerat dhe parimet. Durimi ynë dhe vendosmëria jonë janë të pafundme” - tha Xhonsoni për Vietnamin. Ndonjëherë është

e përshtatshme të mos hysh në kontakte me armiqtë, veçanërisht kur ata janë krejtësisht ekstremistë ose të papajtueshëm, si nazistët apo Al-Kaeda. Por këto janë përjashtime të rralla. Drejtësia e moralit amerikan bën që pazaret të duken natyrshëm të dyshimta. Rreziku është se fuqia dhe moralizmi amerikan, shkakton kundërshtimin ndaj diplomacisë, çka dëmton interesat e Uashingtonit. Për të gjitha burimet e saj të mëdha, Shtetet e Bashkuara nuk mundën zakonisht të zbatojnë vullnetin e vet kundër armiqve, veçanërisht kur topi është në fushën e kundërshtarit. Dhe refuzimi për të bërë kompromis me vlerat amerikane përmes lëshimeve, mund të thotë se duhet paguar një çmim më i madh etik më vonë. Uashingtoni mund të humbasë mundësinë për një marrëveshje të vlefshme dhe të përfundojë duke negociuar si mjeti i fundit, kur ndikimi i tij tashmë është shumë më i dobët.

Shtetet e Bashkuara duhet të kishin hyrë në negociata me talebanët në vitet 2002 ose 2003. Në atë kohë, kryengritësit ishin në arrati dhe mund të ofronin lëshime të mëdha në këmbim të një roli politik të njohur në Afganistanin e ri. Në fund të fundit, talebanët ishin të dobësuar, por jo të mundur. Ata adhuroheshin si shenjtorë në Pakistan. Ka pasur vetëm disa mijëra trupa ndërkombëtare në Afganistan. Një kryengritje ishte gjithmonë e mundur.

Pra, pse të mos negociohej, kur Shtetet e Bashkuara kishin ende letrat më të mira? Në vend të kësaj, Uashingtoni priti deri në vitin 2011, kur lufta ishte degraduar në një moçal, duke pranuar për herë të parë publikisht bisedimet e paqes. Në mënyrë të ngjashme, Shtetet e Bashkuara shmangën negociatat kuptimplota me Iranin, kur Teherani kishte vetëm disa qindra centrifuga, derisa iranianët arritën të ndërtonin një program bërthamor industrial të gjerë.

“Shumë vetë në SHBA i cilësojnë negociatat si një shenjë dobësie” - ka shkruar Henri Kissinger. “Unë gjithmonë i kam parë ato si një armë për garantimin moral dhe psikologjik të një pozicioni të lartë. ... Ky është një mjet për të përmirësuar pozicionin strategjik të dikujt” - shton ai. Për të vënë në punë si duhet këtë armë diplomatike, Obama duhet të manovrojë nëpër një peisazh shumë të vështirë politik.

Për një president demokrat, zgjidhja ideale është të ndërtojë një ekip dy-partiak të politikës së jashtme. Kjo nuk është diçka e lehtë, duke patur parasysh klimën politike hiper-partizane. Por Obama e ka provuar më herët këtë gjë me emërimin e Robert Gejtsit, republikanit të moderuar, si Sekretar i Mbrojtjes. Të dy krizat bërthamore iraniane - e para në Lindjen e Mesme dhe tjetra në Uashington, tregojnë se demokratët po përballen me një kohë të vështirë, duke bërë paqe sipas mënyrës së tyre. Në fund, mund t'i takojë një republikani të shkojë në Iran. /“The Atlantic”/

- **Shënim: Dominic Tierney, është profesor i shkencave politike në “Swarthmore College”. Ai është autori i librit “Si luftojmë: kryqëzatat, moçalet dhe mënyrat amerikane të luftës”.**



Netanjahu fitoi, por me çfarë kosto?

NGA STEVEN COHEN & GERSHON SHAFIR*

Nuk asnjë ka dyshim se kryeministri Netanjahu ka nxjerrë në minutën e fundit një “lepur zgjedhor” nga kutia e votimit. Tej çdo parashikimi, partia e tij Likud, arriti sërish të triumfojë përballë Bashkimit Sionist, që deri në ditën e zgjedhjeve udhëhiqte në sondazhe. Netanjahu e arriti këtë fitore, duke gllabëruar votat e partive të tjera të krahut të djathtë ose nacionaliste. Por pikërisht këtu qëndron edhe problemi i tij. Ai ka një shans të mirë, por larg nga të qenit i sigurtë, për të formuar qeverinë e re, në mandatin e tij të katërt rradhazi. Kjo do të ishte një arritje e rëndësishme afatshkurtër. Megjithatë, prirjet afatgjata kërcënojnë si atë, ashtu edhe bllokun e tij.

Që nga viti 1977, Izraeli ka zgjedhur përherë qeveri të krahut të djathtë, me dy përjashtime: atë të udhëheqësve të laburistëve, Jitzhak Rabin dhe Ehud Barak, të cilët ishin edhe gjeneralë, në një vend tejet të shqetësuar për sigurinë.

Por tani, për herë të parë, një udhëheqës civil nga e majta, Jitzhak Herzog, paraqiti një alternativë të besueshme. Që prej protestave masive të vitit 2011, kryesisht mbi problemet sociale, shumë izraelitë e kanë vendosur standardin e tyre të jetesës dhe polarizimin ekonomik në rritje, në ballë të shqetësimeve të tyre.

Një tjetër kandidat i drejtësisë sociale, Moshe Kahalon, shënoi gjithashtu një rezultat çuditërisht të mirë. Përkundrazi, Netanjahu është përqëndruar më tepër tek Irani, ISIS-i, Hamasi, dhe kërcënimet e tjera reale apo dhe imagjinare të sigurisë. Ai mbetet i brishtë edhe në kampin e protestës sociale. Blloku i majtë ka disa arritje të tjera për të qenë krenarë.

Partia Arabia e Bashkuar do të jetë partia e tretë më e madhe në legjislaturën

e XX-të të Knesetit, dhe do të ketë një ndikim të tillë tek qytetarët palestinezë-arabë, që nuk e ka patur kurrë më parë në Izrael. Është po aq e rëndësishme, që kjo parti e re arabe, zgjodhi të vërë theksin tek dëshirat e votuesve të saj, kryesisht arabë për integrimin dhe barazinë me hebrenjtë, dhe jo për një axhendë separatiste-nacionaliste.

Ishte gjithashtu rasti ideal, në kushtet kur vrulli i disa projekteve të krahut të djathtë, në fund u zbeh. Avigdor Lieberman dhe Naftali Benet, të cilët dukeshin të gatshëm të zgjeroheshin jashtë kampit të emigrantëve dhe nacional-ortodoksëve rusë si dhe të formësonin identitetet e reja edhe më agresive e fetarisht të ndriçuara, panë partitë e tyre të tkurren ndjeshëm në këto zgjedhje.

Së fundmi, një aleancë me të vërtetë shqetësuese e ultra-ortodoksëve, me elementët me shprehës të racizmit të shoqërisë izraelite, nuk arriti të kalonte pragun dhe futej në parlament. Në një periudhë më afatgjatë, rimëkëmbja e Partisë Laburiste (që tashmë njihet si Bashkimi Sionist), dhe kthimi prapa i krahut të djathtë tek projektet ideologjike, do të çojë drejt një Kneseti të ndryshëm.

Është shumë e mundur që vazhdimësia e kryeministrit Benjamin Netanjahu në këtë detyrë, mund të thellojë përçarjet mes hebrenjve amerikanë mbi Izraelin, në muajt dhe vitet që do të vijjnë.

Gjatë dy viteve të fundit, zoti Netanjahu gëzoi partneritetin e aleatëve të qendrës politike dhe personaliteteve të saj (më e dukshmja, ish-Ministrja e Drejtësisë Cipi Livni). Madje u krijua një atmosferë gjoja e vërtetë, për kërkimin e një zgjidhjeje me krijimin e dy shteteve, për konfliktin izraelito-palestinez, dhe shfaqja e një marrëdhënie të mirë pune me presidentin amerikan Obama dhe Sekretarin e tij të Shtetit, Xhon Kerri.

Me fitimin e një mandati të ri qeverisës, ai duhet të menaxhonte krijimin e një koalicioni, që përmbliedhte edhe aleatët e tij të krahut të djathtë dhe ultra-ortodoksët. Por këtë herë, zoti Netanjahu nuk do të ketë në dispozicion asnjë prej tyre. Ai i distancoi ish-aleatët e tij të qendrës me deklaratën e tij një ditë para zgjedhjeve, se do të parandalonte krijimin e një shteti palestinez, ndërsa u rreshtua me udhëheqjen republikane në Kongresin Amerikan, në kundërshtim me Presidentin Obama.

Me presidentin amerikan që përkrah arritjen e një marrëveshjeje të qëndrueshme paqeje mes Izraelit dhe Palestinës, hebrenjtë e Amerikës – sidomos liberalët – do ta gjejnë veten të ndarë, mes Presidentit të tyre dhe një kryeministri izraelit, pozicionet dhe veprimet e të cilit shkaktojnë pak entuziasëm në Uashingtonin e demokratëve, apo edhe tek kryeqytetet evropiane.

Në SHBA, avokatët pro-Izraelit, sionistët liberalë dhe simpatizantët palestinezë do të ndjehen më të detyruar dhe më shumë të justifikuar, për të çuar përpara axhendat e tyre, ndonjëherë duke vendosur më shumë bërëyla se në të shkuarën – duke akuzuar njëri-tjetrin për shkelje të vlerave hebraike, në dëm të sigurisë së Izraelit dhe të popullit hebre. /“The Conversation”/

*** Shënim: Steven M Cohen, profesor dhe studiues në “Kolegjin e Bashkuar Hebre dhe Institutin e Fesë”. Gershon Shafir, profesor i sociologjisë në Universitetin e Kalifornisë.**



Ballafaqimi me ISIS-in

NGA FRANCIS FUKUYAMA

Pika fillestare për një politikë të ndjeshme mbështetet tek kuptimi se SHBA dhe vendet e tjera demokratike nuk kanë arsye të favorizojnë një sekt fetar ndaj një tjetri, në luftën mes sunitëve dhe shiitëve. Kur përballen me mbulimin mediatik të veprimeve makabre të ISIS-it, sikurse janë prerjet e kokave, vendet demokratike thuhet gjithnjë reagojnë me tepri. Sulmet e 11 shtatorit e çuan SHBA-në të pushtojë Irakun në vitin 2003, duke shkaktuar mijëra viktima dhe shpërdoruar qindra-miliarda dollarë, në ndjekje të politikave të cilat ndoshta e përkeqësuan më tej situatën.

Ndërsa duhet të frenojmë ISIS-in, ne gjithashtu duhet të jemi të vetëdijshëm se ajo organizatë terroriste nuk përbën ndonjë kërcënim të afërt apo ekzistencial, ndaj interesave të Shteteve të Bashkuara, ose vendeve të tjera demokratike. Shtypi ndërkombëtar më në fund po e kupton se Shteti Islamik është më pak se një tigër prej letre.

Një ndër kopertinat e fundit të revistës “The Economist” titullohej “Përhapja e frikës, humbje e terrenit”; ajo paraqiste detaje nga ofensiva e fundit ushtarake e qeverisë irakiane kundër Falluxhas, dhe përzënies prej andej të ISIS-it. Duke zotëruar pjesën më të madhe të Sirisë, dhe pushtuar pjesën dërrmuese të Irakut verior, ISIS-i në një moment u duk si një kamion i rëndë e i pandalshëm. Në fakt, ky grup është një organizatë me dobësi të jashtëzakonshme.

Fjala “shtet” në emërtimin e tij është më shumë një aspiratë e dobishme për rekrutimin e militantëve të rinj, sesa një përshkrim i realitetit në terren. Duke qenë një shtet, ai nënkupton aftësinë për të ofruar shërbimet themelore publike si ujë, energji elektrike, kanalizime dhe shkollim, gjërat që ISIS-i nuk ka qenë në

gjendje t'i ofrojë. Shteti Islamik nuk ka dalje në det, dhe territori i tij shtrihet mbi një shkretëtirë shterpë dhe tejet të ekspozuar ndaj sulmeve ajrore. Ato pak burime energjitike si nafta, detyrohet t'i kontrabandojë nëpërmjet Turqisë dhe Irakut. ISIS-i nuk ka thujasë asnjë mbështetës të jashtëm. Kina, Rusia, Evropa, Shtetet e Bashkuara, Irani, dhe praktikisht të gjithë në botën arabe, janë dakord se ajo është një organizatë djallëzore.

Fuqia e saj punëtore vjen si një aleancë jo e natyrshme mes një bande të rinjsh, dështakëve të pakënaqur nga jashtë, dhe baathistëve të mirë-trajnuar, të cilët dikur ishin përkrahës të diktatorit Saddam Husein. Po përse atëherë, ISIS- i shfaqet i fuqishëm dhe kërcënues? Kjo është për shkak se të gjitha shtetet përreth tyre janë shumë të dobët.

Natyrisht, Siria është shembur si shtet. Iraku u qeveris vitet e fundit nga një prej udhëheqësve më të paaftë që ka parë historia kohët e fundit, Nuri al-Maliki, i cili bëri të pamundurën për t'u armiqësuar me minoritetin sunit në vend. ISIS-i po ndjek një model të ngjashëm edhe në vende të tjera, ku terroristët rrjedhin nga territore të qeverisura dobët, si Boko Harami në Nigerinë Veriore. Nuk ka asnjë zgjidhje tjetër afatgjatë, përveç që fuqitë e tjera rajonale të krijojnë institucionet e tyre shtetërore dhe fitojnë aftësinë për të rrimarrë sërish territorin e pushtuar prej këtij grupi.

Objektivi kryesor i ISIS-it nuk janë demokracitë e huaja, por shiitët në Irak, Siri, dhe pjesë të tjera kryesore në Lindjen e Mesme. Ai është pjesë e një lufte të përhapur sektare civile, mes sunitëve dhe shiitëve, një luftë që është ushqyer nga mbështetja e Arabisë Saudite dhe Iranit. ISIS-i paraqet një kërcënim ushtarak akut ndaj fqinjëve të tij shiitë, dhe vepron si një magnet për meshkujt e rinj e të papunë në vendet e tjera, që nuk kanë të dashura apo ndonjë mundësi punësimi. Këta të fundit do të përpiqen të kryejnë veprime të dhunshme, si sulmet në revistën satirike "Charlie Hebdo" në Paris, por duhet të konsiderohen më shumë si kriminelë të rrezikshëm, sesa një kërcënim për sigurinë kombëtare të vendeve jashtë rajonit. Pika fillestare për një politikë të ndjeshme, mbështetet në kuptimin se SHBA dhe vendet e tjera demokratike, nuk kanë arsye që të favorizojnë një sekt fetar mbi një tjetër në këtë luftë.

Asnjë nga lojtarët më të mëdhenj nuk ndan vlera të rëndësishme me demokracitë e botës së zhvilluar; të dyja palët janë fajtorë për nxitjen e terrorizmit dhe destabilizimin e fqinjëve të tyre. Bota e jashtme ka interes për një zgjidhje të qëndrueshme të konflikteve në Irak dhe Siri. Por nëse ka pasur ndonjë mësim që duhet të nxirret nga përvoja amerikane në Afganistan dhe Irak, është se askush në Uashington apo në ndonjë kryeqytet tjetër jashtë zonës së konfliktit, ka mcurinë e nevojshme për të ndërtuar një rend të qëndrueshëm dhe vetëm politik në Lindjen e Mesme, në çdo kohë e në një të ardhme të afërt. Ajo për të cilën bota jashtë ka interes është shmangia e përhapjes së konfliktit në vendet e tjera dhe për aq sa mundemi të mbrojmë njerëzit e pafajshëm nga masakrat. Kjo nënkupton se politika jonë optimale duhet të jetë ajo e kontrollit. Që do të thotë se SHBA dhe aleatët e saj duhet të përdorin fuqinë ajrore dhe ndihmën ushtarake, për të garantuar se asnjë grup, qoftë ISIS apo regjimi i Asadit, të mos jetë aq i fortë sa të mund të imponojë vullnetin e tij në rajon.

Ka një model historik për një politikë të tillë, i cili quhet "offshore balancing" (strategjia përmes së cilës një fuqi e madhe kontrollon rritjen e një fuqie rajonale armike). Kjo është politika klasike që Britania ka ndjekur përballë Evropës. Britania nuk kishte miq apo armiq të përhershëm, dhe do ta hidhte peshën e saj kundër cilësdo fuqi të madhe që dukej se do të dominonte kontinentin.

Gjatë shekujve, ajo e kundërshtoi Spanjën, Francën, Holandën, Gjermaninë, dhe Bashkimin Sovjetik; deri tek luftërat botërore të shekullit XX, ajo ishte shumë e gatshme të çonte trupat në terren dhe ngjarjet, duke ndikuar kryesisht përmes fuqisë detare dhe politikave ekonomike. Ky është lloji i politikës, që demokracitë

e jashtme duhet të ndjekin përkundrejt ISIS-it. Ata duhet të shmangin vendosjen e qëllimeve të forta dhe synimeve të paarrtshme të tipit “Asadi duhet të largohet nga pushteti” ose “të degradojmë dhe shkatërrojmë ISIS-in”, në favor të një politike të balancimit të ketyre fuqive që janë kundër njëra-tjetrës. Ata nuk duhet të krijojnë miq apo armiq të përhershëm, sipas mënyrës së aleancës së NATO-s ose Traktatit të Sigurisë SHBA-Japoni, por më tepër të ruajnë fleksibilitetin, për të punuar me apo kundër palëve të ndryshme në kohë të ndryshme.

Ka pasur shumë frikë se milicia shiite, e angazhuar në betejën për rimarrjen e Falluxhës, do të nxisë revoltën e popullsisë sunite atje, dhe për arsye se trupat qeveritare irakiane po komandohen nga një gjeneral iranian. Këto janë shqetësime të arsyeshme, dhe nëse shiitët kthehen në agresorë, SHBA-ja duhet të ndryshojë palë dhe të mbështesë sunitët. Gjithësesi në këtë proces, ne s’duhet të dërgojmë trupa në terren, por të përdorim sulmet ajrore dhe ndihmën ushtarake kundër cilitdo aktor që duket se po bëhet dominant. Shmangia e një ndërhyrje më të thellë ushtarake është thelbësore, në rast se duam që vendet e rajonit të ndërtojnë institucione të forta dhe marrin përgjegjësinë për sigurinë e tyre.

Prania e rëndë e SHBA-së në Afganistan dhe Irak inkurajoi “lëvizjen e lirë”: irakianët në veçanti nuk e ndjenë se duhej të ndërtonin një shtet të fortë apo forcë të sigurisë kombëtare, për shkak se amerikanët qenë gjithmonë aty, për të bërë punët e vështira.

Komandantët amerikanë duhet të frenojnë veten e tyre dhe të jenë të vetëdijshëm se roli i tyre në këtë betejë është shumë më i vogël se ai i qeverisë në Bagdad. Një politikë e kontrollit dhe balancimit “offshore” është e vështirë për t’u justifikuar ndaj publikut në vendet demokratike. Ajo nuk premtonte një zgjidhje përfundimtare të problemit të terrorizmit, dhe duket cinike në gatishmërinë e saj për të lënë Asadin dhe ISIS-in të luftojnë njëri-tjetrin deri në vdekje. Por alternativat, ose për të mos bërë asgjë, ose për t’u kredhur në konflikt me një forcë masive ushtarake, sikurse SHBA bëri Afganistan dhe Irak, janë shumë më pak tërheqëse. Ky duhet të jetë një mësim, që ne në mënyrë të qartë, e nxjerrim nga përvoja e dekadës së kaluar.

“American Interest”



Të gjithë në rrjetën e krimit kibernetik

Llogaritë online mund të vidhen. Dronet mund të transportojnë drogë ose bomba, në vend të picave, printerat 3D mund të nxjerrin armë. Telekamerat e pajisjeve tona mund të merren peng. Ashtu si GPS e avionëve dhe anijeve. Një ekspert ilustron anën e errët të teknologjisë së lartë të kontrolluar përmes internetit. Dhe në fund, shtatë këshilla për të lundruar në ujëra të sigurtë...

Teknologjitë e reja që çdo ditë e më shumë po na revolucionarizojnë jetën, rrezikojnë të na kthehen kundër. Ndërkohë që festojmë epokën e “të gjithëve dhe gjithçkaje të lidhur në rrjet”, të dronëve që sjellin picat, të GPS që na orienton

dhe printerave 3D që prodhojnë pajisje, vjen si gjithmonë kukuvajka, që të na prishë festën. Quhet Marc Goodman, 40 vjeç, ish polic në Los Angeles, ekspert i krimit kibernetik, sot konsulent i qeverive dhe kompanive private në 70 vende të ndryshëm. Thirrja e tij e alarmit quhet “Future Crimes” (Krimet e të ardhmes) dhe tregon mënyrë rrethore se si kriminelë, mafie, fuqi armiqësore dhe terroristë janë duke përfituar prej rrjetit global për qëllimet e tyre, dhe se si në të ardhmen teknologjitë e reja do ta bëjnë jetën e tyre edhe më të vështirë, ndërsa tonën një ferr të vërtetë. Që tani vlerësohet se vetëm në vitin 2013, krimi në internet ka xhiruar 400 miliardë dollarë. Por është një vlerësim deri diku i hamendësuar. Në janar, për të marrë një shembull, kriminelë kibernetikë penetruan në rrjetet e njëqind bankave të botës duke përdorur viruse që barteshin në mënyrë të pavetëdijshme nga të punësuarit: mes llogarive rrjedhëse të boshatisura dhe bankomatëve të piratuar, arritën të vjedhin një shifër mes 300 dhe 900 milionë dollarë.

“Ky episod”, shpjegon informaticieni Stefani Fratepietro, docent në Universitetin e Modenës dhe Reggio Emilias, “ilustron më së miri se si pika e vërtetë e dobët e shoqërisë së super ndërlidhur është mungesa e një edukimi masiv në përdorimin e këtyre pajisjeve. Sot janë bërë të rrallë sulmet kompleksë kundër rrjeteve publike apo private super të mbrojtur, që përgjithësisht kryhen prej atyre hacker-ave që kanë dëshirë të demonstrojnë zotësinë e tyre. Ndërkohë që janë shumëfishuar në mënyrë eksponenciale sulmet kundër miliona përdoruesve të zakonshëm që kryhen përmes “phishing” (mashtuesit paraqiten si përfaqësues bankash apo kompanish të mëdha duke kërkuar të dhëna personale) apo viruse të fshehur në faqe interneti të pasigurta, soe të shkarkuar me aplikacione. Pasi i kanë “infektuar”, prej kompjuterëve apo celularëve kriminelët mund të tërheqin të dhëna dhe fjalëkalime, për t’u futur në faqe të mbrojtura, si ato të bankave, apo në rrjetet e punës”.

Por për Goodmanin, e gjithë kjo është histori e vjetër. Mbërritja në masë e smart-phone-ve dhe tani e “internetit të gjërave”, domethënë lidhja në rrjet e televizorëve, makinave, lojërave, robotëve, elektroshtëpiakeve apo telekamerave, do u mundësojë keqbërësve të teknologjisë që të veprojnë jo më vetëm në botën virtuale të internetit, por edhe në botën reale.



“Smartphonet dhe tabletët janë vecanërisht në rrezik, sepse mund të merret kontrolli edhe i telekamerave të tyre, mikrofonëve dhe GPS: një gjë ideale kjo për gjahtarë dhe spiunë”, shpjegon Goodman. Apo për “Vëllezërit e mëdhenj” të çfaërdolloji. Studentët e shkollës së lartë të Louer Merion në Pensilvani kanë zbuluar për shembull se janë të kontrolluar, edhe në shtëpi, nga drejtori, i cili përdorte për këtë qëllim tabletët që kishte ofruar vetë shkolla. “Por më e keqja nuk ka ardhur ende sepse, nëse sot janë 13 miliardë pajisje online, në vitin 2020 mund të arrijnë në 50 miliardë”.

Një shembull i kësaj Bote të Re ilustrohet nga ajo që i ka ndodhur në vitin 2013 Croun Casino-s në Melbourne: kriminelë kibernetikë u futën përmes internetit në telekamerat e saj dhe i përdorën për të parë letrat e atyre me të cilët luanin poker. 32 milionë dollarë humbje brenda një nate. Pastaj ka hajdutë dhe maniakë që mund të marrin kontrollin e telekamerave në apartamente, për të përgjuar banorët. “Por nuk janë vetëm kriminelët që infiltrohen në shtëpitë tona”, kujton Fratepietro. “Është zbuluar se mikrofonët e televizorëve smart Samsung qëndronin gjithmonë ndezur, duke dërguar atë që përgjonin në një faqe të kompanisë, ndoshta për t’ua shitur ato të dhëna kujtdo që donte informacione mbi programet që ndiqeshin”. Edhe pajisjet mjekësore që shpëtojnë jetë, të lidhura në rrjet për kontrollin mjekësor fshehin rreziqe: në vitin 2012, hackeri Barnaby Jack demonstroi se mund të bëjë të lëshojë një shkarkesë prej 800 volt, një defribilator i implantueshëm.

Lidhja e gjithçkaje lejon edhe kontrollin në distancë të centralit të makinës, një mundësi reale kjo në disa modele, për të provokuar aksidente. “Dhe çfarë do të ndodhë”, pyet Goodman, “me makinat pa shofer? Nëse siguria e tyre informatike nuk do të jetë e hekurt, mund të përdoren si armë apo për të rrëmbyer njerëz”. Duam të shohim edhe më larg? Kur automjetet pa shofer do të jenë të zakonshëm në rrugë, shtëpi dhe zyra, dikush mund të marrë kontrollin në distancë, e t’i përdorë si robotë për të kryer sulme pa riskuar aspak.

Lidhja e gjithçkaje në rrjet është shndërruar sot në një parajsë për spiunët: në vitin 2011 u zbulua se dikush nga Kina kishte hyrë në rrjetin e Dhomës së Tregtisë në Uashington, duke penetruar nga një termostat i lidhur në internet, duke arritur kështu të kuptojë të fshehtat industriale që kalonin në kompjuterë. Rreziku më i keq është që edhe terrorizmi të bëhet kibernetik dhe të përdorë mundësitë e reja teknologjike për të kryer sulme shkatërrimtarë. Për shembull duke ndryshuar sinjalet GPS që udhëheqin anije dhe avionë. Që kjo është e mundur, e kanë demonstruar në vitin 2013 dy studentë të MIT, duke devijuar nga rruga jahtin “Trëndafili i Bardhë” i Drachs, ndërkohë që nga ata që ishin në bord, askush nuk mori vesh gjë.

Dhe dronët? Që tani, përdorimi që u bëjnë narkotrafikantët për të trafikuar drgoë përtej kufirit amerikan tregon se sa e vështirë është të kapen. Tani makthi është që të përdoren prej terroristëve për të transportuar bomba: në vitin 2010, një arabo- amerikan i kapur nga FBI, ishte gati të sulmonte Pentagonin dhe Kongresin duke përdorur tre drone të vegjël të telekomanduar dhe të mbushur me eksplozivë.

Edhe printerat simpatikë 3D kanë anën e tyre të errët: në rrjet janë të disponueshëm projekte pistoletash për t’u printuar në plastikë, të pakapshme nga detektorët metalikë. Për momentin janë të dobëta, por në të ardhmen printerat 3D mund të printojnë polimere më rezistentë, dhe atëherë “armët e bëra vetë” do t’u shtohen atyre industriale.

Një kapitull më vete i kushtohet rreziqeve të bioteknologjive. “Në vitin 2012 u pengua botimi në revistat shkencore i detajeve se si mund të bëhet më ngjites virusi H5N1”, kujton Goodman, “por megjithatë procedura u shfaq në internet pak kohë më vonë: mendoni sikur terroristët të kishin laboratorë dhe aftësi për të përdorur informacione si këta për të krijuar viruse”.

Në fund ekziston rreziku që keqbërësit kibernetikë të bllokojnë apo ndryshojnë impiantet e rrjeteve të energjisë elektrike, gazit apo ujit të pijshëm: shumë prej këtyre kontrollohen përsëlargu dhe mbikëqyren prej sistemeve të vjetër operative, të lehtë për t'u infiltruar. Ka ndodhur tashmë: në vitin 2007, kriminelë kibernetikë sulmuan centralet elektrike në Barzil, duke lënë në errësirë 3 milionë vetë. "Pra", konkludon Goodman, "nuk do të arrijmë të kontrollojmë as risqet ekzistues, e megjithatë vazhdojmë të shtojmë teknologji të reja, të pasigurta, të cilave u delegojmë detyra gjithnjë e më të rëndësishme".

Si mund të shpëtojmë? Duke parë që hacker-ët përdorin gabimet e programeve për të ndërhyrë në sisteme, duhet të bëhen përgjegjës shkaktarët e dëmeve që i lënë këta defekte. U duhen ofruar stimuj të rëndësishëm financiarë hacker-ëve që gjejnë këta gabime, me qëllim që të mos tundojnë t'ua shesin kriminelëve. Por mund të krijohen edhe agjenci ndërkombëtare për sigurinë në internet, që mund të veprojnë me shpejtësi në të gjithë botën, duke përdorur teknologjitë e fundit, pikërisht ashtu si bëjnë kriminelët kibernetikë. Si dhe të krijohen ekipe "zjarrfikësish" kibernetikë, që bllokojnë rreziqet në rrjet, sapo këta shfaqen. Do të ishte e nevojshme edhe një OKB kibernetike që të koordinojë në nivel ndërkombëtar reagimin ndaj rreziqeve që përhapen në internet.

Por mbi të gjitha, duhet të krijohet një lloj Projekti Manhattan në shkallë botërore: gjatë Luftës së Dytë Botërore, Shtetet e Bashkuara bënë një përpjekje të madhe industriale, shkencore, politike dhe financiare për të mbërritur tek bomba atomike përpara nazistëve dhe japonezëve. E njëjta gjë duhet bërë tani për të eliminuar rreziqet e teknologjisë, duke përfshirë qeveri dhe industri në vendosjen e standarteve të fortë për të gjithë produktet dhe sistemet e teknologjisë së lartë.

SHTATE KESHILLA PER TE LUNDRUAR NE UJERA TE SIGURTE

1. 95% e krimeve kibernetike bazohen në gabime njerëzore: nuk duhen shkarkuar aplikacione apo materiale për të cilët nuk jemi të sigurtë. Nuk duhet të futeni as në faqe interneti të pasigurta
2. Mos ua besoni sigurinë e pajisjeve vetëm antivirusëve: ata mund të shmangen në një kohë të shkurtër prej keqbërësve
3. Duhen futur sisteme identifikimi të bazuar mbi të dhënat biometrike (shenja gishtërinjsh, syri), më komplekse për t'u shamngur se sa fjalëkalimet
4. Mos bini pre e phishing (mashtroes që duke bërë gjoja sikur janë banka apo kompani të mëdha, kërkojnë të dhënat tuaja në internet)
5. Bëni kujdes ndaj sinjaleve të infektimit, si ngadalësimi i kompjuterit
6. Shmangni vendosjen e të dhënave personale, informacioneve të rezervuar apo fotove kompromentuese në rrjetet sociale: privatësia në internet është gjithmonë në rrezik
7. Denonconi në polici cdo përpjekje për t'u futur në kompjuterin tuaj

/L'Espresso/

